



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.137**

**6 tetor**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM  
nr.619, datë 7.9.2011

Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për efijencën e  
energjisë, 2011-2018.....

Faqe

6181

**VENDIM**  
**Nr.619, datë 7.9.2011**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR EFIÇENCËN E ENERGIJISË, 2011-2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e planit kombëtar të veprimit për efikasitetin e energjisë, 2011-2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**PLANI KOMBËTAR**  
**I VEPRIMIT PËR EFIÇENCËN E ENERGIJISË 2011-2018**

**SHKURTIMET**

EE	Efikasiteti i energjisë
PEE	Përmirësimi i efikasitetit të energjisë
DPEN	Direktiva e performancës energjetike në ndërtesa
ESD	Direktiva e shërbimeve të energjisë
EE	Efikasiteti i energjisë
STE	Skema e tregtimit të emetimeve
EU	Bashkimi Europian
FEE	Fondi për efikasitetin e energjisë
PKVEE	Plani kombëtar i veprimit të efikasitetit të energjisë
Ktoe	Kilo ton naftë ekuivalent
RES	Sistemet e energjiave të rinovueshme
SME	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
KTFE	Konsumi total final i energjisë
GLN	Gaz i lëngëzuar i naftës
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

**1. Parathënie**

Plani kombëtar i veprimit për efikasitetin e energjisë (PKVEE) është bazuar në direktivat e poshtëpërmendura të Bashkimit Europian: direktiva 2006/32/EC mbi "Përdorimin me efikasitet të energjisë për përdoruesit fundorë dhe shërbimet energjetike", direktiva 2002/91/EC "Performanca energjetike në ndërtesa" (amenduar me 2010/31/EP), direktiva 92/75/EC (e amenduar me direktivën e 2010/30/EP).

PKVEE-ja përmban përshkrimin e masave që duhet të ndërmerren për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sektorët e ekonomisë, të planifikuara me qëllim realizimin e objektivave të

EE-së për periudhën afatshkurtër, deri në vitin 2012 dhe për periudhën afatgjatë, deri në vitin 2018, nëpërmjet zbatimit të politikave për efikasitetin e energjisë.

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në të gjithë sektorët ekonomikë është edhe një nga qëllimet kryesore të parashikuara në strategjinë kombëtare të energjisë (e përditësuar).

#### 1.1 Përshkrim i shkurtër i konsumit energjetik në sektorët ekonomikë

Konsumi final energjetik në vitin 2008 është i barabartë me 1841 Ktoe. Kontributi i sektorëve është përkatësisht: 23% sektori i banesave, 44% sektori i transportit, 13% industria, 10% shërbimet, 10% bujqësia.

Sipas bilancit energjetik të vitit 2008, sektori i banesave zë vendin e parë për sa i takon konsumit të energjisë elektrike me 47% kundrejt totalit të konsumit të tij në vend. Gjithashtu, ky sektor konsumon në vlera të larta dru zjarri, me rreth 42% të totalit dhe nënprodukte të naftës me 3.8% dhe të tjera me 7.2% energji diellore.

Duke marrë parasysh faktin se Shqipëria nuk e ka të zhvilluar sistemin e gazit natyror, sepse ka një prodhim të papërfillshëm të tij dhe në të njëjtën kohë nuk është e lidhur me rrjetin evropian të gazit, pothuajse të gjitha shërbimet energjetike (ngrohja e hapësirave, gatimi dhe uji i ngrohtë sanitar), për sektorët e banesave dhe të shërbimeve mbulohen nga energjia elektrike, drutë e zjarrit dhe nënproduktet e naftës, veçanërisht GLN-ja.

Duke qenë se burimet e energjisë përdoren në të gjithë sektorët e ndryshëm të ekonomisë, si në sektorin e banesave, shërbimeve publike dhe private, industri, transport dhe bujqësi, lidhja midis zhvillimit ekonomik të një vendi dhe kërkesës së tij për energji konsiderohet një problem kyç dhe kërkon zhvillimin e një sistemi energjetik mbështetës.

Aktualisht, intensiteti i energjisë në Shqipëri është relativisht i lartë (figura 1). Kjo do të thotë që konsumi total i energjisë ka qenë i lartë në raport me prodhimin makroekonomik (GDP). Kjo lidhet me zhvillimin e ulët industrial të Shqipërisë, teknologjitë e vjetra dhe me faktin që pjesa më e madhe e konsumit të energjisë shkon për sektorin e banesave, shërbimeve etj.




Figura 1: Intensiteti energjetik 2006-2008

Analiza e figurës 2 tregon që kërkesa për energji për çdo sektor ka qenë: 2063 Ktoe në vitin 2004 deri në 1841 Ktoe në vitin 2008. Siç tregohet në këtë figurë, konsumatori kryesor është sektori i transportit, i ndjekur nga sektorët e banesave dhe industrisë. Ndërsa analiza e furnizimit me burime energjetike tregon që rol kryesor kanë luajtur nënproduktet e naftës, energjia elektrike, drutë e zjarrit dhe GLN-ja.




Figura 2. Konsumi energjetik sipas sektorëve (%)

Konsumi i energjisë në sektorin e banesave merr parasysh këto shërbime energjetike: ngrohje hapësirash, kondicionim ajri, ujë të ngrohtë sanitar, gatim, ndriçim dhe pajisje elektroshtëpiake. Për rrjedhim, është e rëndësishme të dihen se cilat do të jenë mundësitë për kursimin e burimeve të energjisë, si: energjia elektrike, drutë e zjarrit, GLN-ja.

Që nga viti 2000, furnizimi me energji dhe kërkesa për ngrohje hapësirash, gatim dhe ujë të ngrohtë sanitar (duke përdorur kryesisht drutë e zjarrit) mbeten në balancë. Pas vitit 2000, vihet re një rënie e furnizimit me dru zjarri për nevojat energjetike në sektorin e banesave, e shoqëruar, gjithsesi, me fenomenin e prerjeve të tyre (kryesisht ilegale) dhe me mbingarkesë të pajisjeve elektrike.

PKVEE-ja sipas kategorive merr parasysh: ndërtesat me një banesë, ndërtesat me shumë banesa dhe ku secila kategori prej tyre ndahet në: të reja, ekzistuese, të rinovuara dhe sipas klasifikimit të pajisjeve elektroshtëpiake.

Sektori i shërbimeve ka në konsideratë kategoritë e shërbimit publik dhe privat, por të ndara këto në ndërtesa ekzistuese, ndërtesa të reja, dhe sipas pajisjeve efçente të energjisë (këto të fundit të klasifikuara dhe të etiketuara). Sektori i shërbimit publik ka një eksperiencë të hershme në kërkesën për energji, bazuar kryesisht kjo në teknologjinë e vjetër, instalimet dhe organizimin e vjetër. Vetëm në disa raste njihen skemat e reja. Sistemi i të dhënave për sasinë e energjisë së kërkuar për çdo shërbim dhe kontributi përkatës bazohet në disa studime dhe vlerësime ekspertësh, por duhet thënë se mbetet problematik sigurimi i të dhënave të detajuara. Duhet theksuar, gjithashtu, se ngrohja e hapësirave, uji i ngrohtë sanitar dhe ndriçimi. Për të gjithë nënsektorët në përgjithësi është realizuar në mënyrë të pamjaftueshme, me cilësi të ulët, për shkak edhe të mungesës së fondeve të nevojshme buxhetore për mbulimin e kërkesës për energji. (Ngruhja qendrore/lokale në vend është e pazhvilluar me përjashtim të ndonjë CHP-je (si në qendrën spitalore në Tiranë, në Qytetin Studenti etj.).

Kontributi i sektorit të shërbimeve në konsumin final të burimeve energjetike është respektivisht: 22.6% energji elektrike, 9.9% dru zjarri, 5.5% nënprodukte të naftës.

Sektori i industrisë ndahet në nënsektorët e mëposhtëm: metalurgji, kimi, materiale ndërtimi, miniera, ushqim/pije/duhan, tekstil/lëkurë/këpucë, dru/letër/stampim, mekanike dhe të tjera. Analiza e zhvillimit ekonomik gjatë periudhës 2003-2008 tregon rënien e konsumit të burimeve energjetike nga 18% në 13%.

Burimet energjetike në sektorin e industrisë janë energjia elektrike me 17% dhe nënproduktet e naftës me 11.9%.

Burimet e energjisë në nëndegët e këtij sektori konsumohen për vënien në punë të fuqive motorike, procesin e arritjes së temperaturës së ulët dhe të lartë, si dhe për procese të ndryshme të tjera pune apo për ndriçim.

Sektori i transportit në Shqipëri filloi të zhvillohej me ritme të shpejta pas viteve '90, ku përveç rritjes sasiore të transportit rrugor, filloi të zhvillohej edhe infrastruktura e kapaciteteve transportuese të rrugëve, hekurudhave dhe transporti detar. Sektori i transportit luan një rol të rëndësishëm në konsumin e burimeve energjetike, me 44% të konsumit total final (viti 2008). Rritja e numrit të mjeteve të transportit pas viteve 2000, veçanërisht në transportin rrugor, u shoqërua me rritjen e aktivitetit të tij dhe me rritje të dukshme të konsumit të lëndës djegëse, të naftës dhe të benzines. Vëmë në dukje se nuk ka pasur ndonjë zhvillim për sa i përket rritjes së kontributit të transportit publik dhe kryesisht atij hekurudhor.

Shqipëria do të vazhdojë të mbetet për shumë vjet një vend ku dominon bujqësia. Peshat specifike në GDP është rreth 40% e totalit të saj. Konsumi i energjisë shkon në prodhimin e të mbjellave dhe për bagëtitë, të cilat mbeten dhe alternativat kryesore për zhvillimin ekonomik dhe social.

Bujqësia konsumon më pak se 10% të totalit të energjisë finale. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë kushtëzohet nga shumë faktorë, ku më të rëndësishmet janë:

- Ferma të vogla dhe të ndara;
- Probleme me tokat e punueshme;
- Çmime shumë të larta të prodhimeve, një prodhim i paorganizuar dhe sistem joefektiv i shpërndarjes së prodhimit bujqësor;
- Mungesa ose pamjaftueshmëria e kreditimit bujqësor;
- Mungesa ose pamjaftueshmëria e mekanizmave bujqësore.

## 2. Pamje e përgjithshme dhe tabelat përmbledhëse të konsumit energjetik

Për vitin 2008, furnizimi final me burime energjetike në Shqipëri llogaritet në 2118 Ktoe. Në kuadër të objektit që përfshin dhe mbulon direktivat e Bashkimit Europian mbi shërbimet energjetike (ESD), konsumi final i burimeve energjetike për vitin 2008 ka qenë në nivelin e 1841 Ktoe. Konsumi energjetik përkundrajt totalit të konsumit final, sipas burimeve energjetike është: qymyri 1,2%, produktet e naftës 64.4%, energjia elektrike 22.7%, drutë e zjarrit 11.7%.

Konsumi energjetik sipas sektorëve është: Industria 13%, transporti 44%, banesat 23%, shërbimet 10%, bujqësia dhe të tjera 10%.

Problemet më të rëndësishme me të cilat do të përballlet në të ardhmen zhvillimi ekonomik i vendit dhe sektori energjetik në veçanti, janë rritja e konsumit të energjisë për banorë dhe mbajtja në të njëjtën kohë e një niveli relativisht më të ulët të intensitetit të energjisë, të cilat kërkojnë nxitjen e një ekonomie eficiente dhe konkurruese. Intensiteti i energjisë në Shqipëri konsiderohet i lartë krahasuar me vendet e rajonit. Për rrjedhojë, sektori i energjisë në Shqipëri do të vazhdojë të përballlet me dy sfida të rëndësishme: (i) mbajtjen e këtij intensiteti në nivele mesatare, dhe (ii) rritjen e konsumit të energjisë për banorë (rritjen e komoditetit të jetës). Për parashikimin e kërkesës për energji për periudhën 2010-2018 është konsideruar një rritje mesatare e prodhimit të brendshëm bruto (GDP) mesatarisht me 4.5%). Tabela 1 paraqet parashikimin afatgjatë të kërkesës për energji në të gjithë sektorët bazuar në studimet e AKBN-së.

Tabela 1. Parashikimi i konsumit të energjisë për gjithë sektorët (Ktoe) (2010-2018)

Sektorët	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Banesa	521	455	423	430	447	456	465	476	488	501	515	530	652	661
Shërbime	206	144	107	195	171	189	211	235	263	296	333	376	492	508
Industri	243	320	254	230	286	294	302	311	322	333	345	359	624	646
Transport	871	708	723	811	739	746	754	763	771	781	791	801	777	785
Bujqësi	143	134	204	206	218	223	228	234	239	245	250	256	343	346
<b>Total</b>	<b>1984</b>	<b>1761</b>	<b>1711</b>	<b>1841</b>	<b>1861</b>	<b>1908</b>	<b>1961</b>	<b>2019</b>	<b>2083</b>	<b>2155</b>	<b>2234</b>	<b>2323</b>	<b>2890</b>	<b>2947</b>

Shqipëria akoma nuk aplikon skemën e tregtimit të emetimeve (STE). Targetat (objektivat) kombëtarë të përmirësimit të efijencës së energjisë (PEE) llogariten në bazë të metodologjisë së

dhënë në aneksin I të direktivës së sipërpërmendur. Për këtë qëllim, të dhënat mbi konsumin final të energjisë gjatë periudhës 2004-2008 janë përdorur si bazë për parashikimin e kursimeve të burimeve të energjisë deri në vitin 2018 në sektorët ekonomikë.

PKVEE-ja siguron një paketë masash për t'u zbatuar për përmirësimin e efijencës në sektorët: e banesave, të shërbimeve, industri, transport dhe vlerësime për kursimin e energjisë në sektorin e bujqësisë.

Potencialet për kursimin e energjisë, në kuadër të planit kombëtar të veprimit për efijencën e energjisë, për secilin nga sektorët e lartpërmendur përkundrejt konsumit final të energjisë janë paraqitur të përmbledhura në figurën 3. Parashikimi i kursimeve është llogaritur duke mbajtur në konsideratë paketën e masave, që duhen aplikuar në vitet në vazhdim. Llogaritja bazohet në vlerësimet e ndikimit të çdo mase të përfshirë në PKVEE-në për kursimet energjetike dhe të potencialeve reale, që sektorët ekonomikë përmbajnë.

Vlerësimet janë bazuar, kryesisht, në disa llogaritje specifike të bazuara në statistikat që ekzistojnë dhe në vlerësimin e ekspertit. Disa nga këto vlerësime janë konsideruar në grup. Është marrë në konsideratë vlerësimi nga lart poshtë. Pra, theksojmë se këto vlerësime nuk janë bazuar dhe rrjedhur nga përdorimi i programit MURE-ODYSSEE (soft që kalkulon kursimet e energjisë).

Është e rëndësishme të vihet në dukje që masat për efijencën shpeshherë ndërthuren me njëra-tjetrën.

Zbatimi i PKVEE-it, i pari në Shqipëri aktualisht, është edhe faza fillestare e implementimit të politikës kombëtare për efijencën e energjisë. Natyrisht, në këtë periudhë duhen zgjidhur disa probleme dhe mangësi, që rezultojnë nga moszbatimi i kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e efijencës së energjisë.

Për këtë kërkohet:

- adoptimi i kuadrit ligjor për efijencën e energjisë, në harmoni me direktivat e Bashkimit Europian;
- zbatimi i përpiktë i kuadrit ligjor mbi “efijencën e energjisë” dhe i planit të veprimit për efijencën e energjisë;
- nxitjet dhe mbështetjet financiare për investime për efijencën e energjisë;
- zhvillimi i fushatave sensibilizuese;
- hyrja në treg e kompanive të shërbimit për zbatimin e masave për EE-në.

Duhet pasur parasysh që kursimi i energjisë në vitet e para do të jetë në nivele modeste (objektivi prej 3% kërkon patjetër kohë për të shfaqur efektet e investimeve, që parashikohen të kryhen në vitet 2011-2012 dhe efektet e kursimeve do të jenë më të dukshme në fund të periudhës, në të cilën janë parashikuar arritjet e objektivave për kursimin e energjisë).




Figura 3. Kërkesa totale për energji, kursimi i energjisë dhe objektivi afatshkurtër dhe afatgjatë në %.

Në këtë mënyrë, është me normale të parashikojmë ritme më të ngadalta të realizimit të objektivave për efijencën e energjisë për periudhën e parë, deri në 2012 dhe më pas, duke kompensuar pjesën tjetër, nëpërmjet rritjes së ritmeve të arritjes së objektivave deri në vitin 2018.

Në periudhën e dytë (trevjeçare) parashikohet që kursimi i energjisë do të jetë më i lartë për shkak të krijimit të kuadrit ligjor dhe institucional dhe fillimit të zbatimit të tij, viteve të eksperiencës dhe zbatimit të masave në secilin sektor, të cilët do të përfshihen në periudhën e planifikuar.

Bazuar në analizat dhe supozimet e mësipërme, norma prej 3% e kursimit të energjisë në 2012 dhe 9% në 2018, si rrjedhojë janë të pranueshme. Tabela 2 paraqet pjesëmarrjen dhe kontributin e çdo sektori në totalin e konsumit të energjisë të shprehur në përqindje.

Tabela 2. Parashikimi i kontributit të konsumit të energjisë sipas sektorëve (%) (2009-2018)

Sektorët	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Banesa	24.0%	23.9%	23.7%	23.6%	23.4%	23.2%	23.0%	22.8%	22.5%	22.4%
Shërbime	9.2%	9.9%	10.7%	11.6%	12.6%	13.7%	14.9%	16.2%	16.9%	17.2%
Industri	15.4%	15.4%	15.4%	15.4%	15.4%	15.5%	15.5%	15.5%	18%	21.9%
Transport	39.7%	39.1%	38.5%	37.8%	37.0%	36.2%	35.4%	34.5%	30.8%	26.7%
Bujqësi	11.7%	11.7%	11.6%	11.6%	11.5%	11.3%	11.2%	11.0%	11.8%	11.8%
Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Gjatë kësaj periudhe parashikohet që konsumi energjetik në sektorin e shërbimeve do të rritet gradualisht (përfshirë plotësimin e kërkesës për energji në sektorin e turizmit, i parë ky si një prioritet), duke çuar në një konsum më të madh të burimeve të energjisë në fund të vitit 2018. Kjo situatë pritet të ndodhë edhe në sektorin e industrisë. Nga ana tjetër, përqindja e pjesëmarrjes së të gjithë sektorëve të tjerë në konsumin e energjisë, do të reduktohet në vlera relative, duke përfshirë sektorin e banesave, pjesa (aksioni, shpërndarja) e të cilit do të reduktohet nga 24% në 2009 në 22.4% në 2018.

Shpërndarja e kontributeve të sektorëve të ndryshëm, në gjithë konsumin e energjisë në Shqipëri (mesatarisht për periudhën 2003-2008), në krahasim me shpërndarjet e sektorëve të ndryshëm në konsumin e energjisë në Bashkimin Europian paraqitet në tabelën 3:

Tabela 3. Shpërndarja e kontributit të konsumit energjetik sipas sektorëve (%)

Vendi	Shqipëria	Shtetet e BE-së
Banesa	23	26.28
Shërbime	11	12.47
Industri	12	27.77
Transport	44	30.91
Bujqësi	10	2.54

Objektivi i ndërmjetëm i kursimeve të energjisë do të jetë më pak se 3% e konsumit mesatar gjatë periudhës trevjeçare të referuar, pa marrë në konsideratë konsumin e transportit ajror. Në përcaktimin e targetave (objektivave) kombëtare për përmirësimin e efijencës së energjisë (PEE) për periudhën e ndërmjetme 2011-2012, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

1. Zbatimi jo i plotë i ligjit ekzistues për efijencën e energjisë (prill 2005);
2. Mungesa e krijimit të fondit të efijencës së energjisë;
3. Mungesa e zbatimit të Kodit Energjetik të Ndërtesave në fushë të gjerë;
4. Mungesa e një legjislacioni sekondar dhe rregullator për kryerjen e monitorimeve dhe auditimeve energjetike për konsumatorët e mesëm dhe të mëdhenj, si dhe mungesa e sistemit të certifikimit për audituesit e energjisë;
5. Mungesa e procedurave të përshtatshme ligjore për prokurimin e pajisjeve efijente;
6. Mungesa e kompanive që sigurojnë përmirësimin e efijencës së energjisë nëpërmjet shërbimeve energjetike.

Faktorë pozitivë, që garantojnë procesin e implementimit të PKVEE-së në Shqipëri, janë:

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka rritur ndjeshmërinë mbi rëndësinë e këtij komponenti, siç është përmirësimi i efikasitetit të energjisë, si një element shumë i rëndësishëm në rritjen e sigurisë së furnizimit me burime energjetike.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, së bashku me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore janë në procesin e përgatitjes së draftit të ri të ligjit për efikasitetin e energjisë.

3. Rritja e nivelit të kapaciteteve profesionale mbi efikasitetin e energjisë brenda Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) me mbështetjen e BE-së dhe donatorëve si KfW USAID, GTZ etj.

4. Procesi i mbarëvajtjes për nxitjen e përdorimit të energjisë diellore nëpërmjet financimit të projektit nga PNUD dhe Qeverisë Shqiptare.

5. Kontributi i KfW për projektin e implementimit të masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike me 250,000 euro.

6. Ministria Italiane e Mjedisit, Tokës dhe Detit i ka akorduar METE-s një grant prej 5 milionë eurosh për projektet e energjive të rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë (ka filluar procesin e identifikimit të projekteve).

7. Pjesëmarrja aktive në programet e zhvillimit të efikasitetit të energjisë nga BB, BERZH, KfW në kontekstin rajonal, nga të cilat mund të përfitojnë shumë projekte të efikasitetit të energjisë në sektorin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme (SME).

8. Në janar të vitit 2008 Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën (UNECE) filloi fazat e para për zbatimin e projekteve për financimin e efikasitetit të energjisë dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, ku përfshihet edhe Shqipëria.

9. Gjatë 2011-tës parashikohet të përgatiten procedurat për audituesit e energjisë dhe të certifikohen audituesit e parë të energjisë.

10. Ka interes të vazhdueshëm për auditimin e energjisë nga sektori privat.

3. Objektivat kryesorë kombëtare për përmirësimin e efikasitetit të energjisë

Treguesit e plotësimit të objektivave janë shpërndarë sipas sektorëve të konsumit final të energjisë, prandaj edhe efektiviteti i masave të propozuara duhet të monitorohet në mënyrë specifike sipas sektorëve. Autoritetet dhe organizatat e ndryshme kanë të drejtën dhe detyrimin për zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë në sektorë të ndryshëm. Shpërndarja sektoriale e objektivave kombëtare bazohen kryesisht në:

- potencialet për përmirësimin e efikasitetit sipas sektorëve të ndryshëm;

- nivelin e ndërhyrjeve politike në fushën e efikasitetit të energjisë në çdo sektor;

- ndarjen e sektorëve në mënyrë individuale brenda konsumit final të energjisë;

- koncepti i kostos më të ulët të masave të ndryshme të efikasitetit të energjisë për sektorë të ndryshëm (nxitja e masave efektive me kosto më të ulët).

Siç dihet, sektorët e transportit, të banesave dhe të shërbimeve kanë peshën më të madhe në konsumin final të energjisë. Megjithatë, kursimet e parashikuara nuk bëhen vetëm në bazë të këtyre përqindjeve, por gjithashtu mbi bazën e vlerësimeve të ndikimeve të masave të propozuara për përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Shpërndarja e objektivave të ndërmjetëm të kursimit të energjisë të llogaritur është paraqitur në tabelën 4.

Tabela 4. Shpërndarja e objektivave për kursimin e energjisë sipas sektorëve

Sektori	%
Banesa	22
Shërbime	19
Industri	25
Transport	31
Bujqësi	3
<b>Total i potencialit të kursimeve</b>	<b>100%</b>



Bazuar në shpërndarjen e niveleve të kursimit të energjisë, midis sektorëve të ndryshëm, është llogaritur potenciali i kursimit të energjisë për çdo sektor siç tregohet në tabelën 5.

Tabela 5. Objektivat kombëtarë të kursimit të energjisë

Objektivat kombëtarë orientues të kursimit të energjisë 2018 (Ktoe)		168		
Objektivat kombëtarë orientues të ndërmjetëm të kursimit të energjisë 2012 (Ktoe)		26		
Masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë të planifikuara për arritjen e objektivave	Kursimet vjetore të energjisë të parashikuara në 2012 (Ktoe)	Kursimet vjetore të energjisë të parashikuara në 2018 (Ktoe)	Reduktimi i emetimeve vjetore CO <sub>2</sub> deri në 2012 (kgCO <sub>2</sub> /vit)	Reduktimi i emetimeve vjetore CO <sub>2</sub> deri në 2018 (kgCO <sub>2</sub> /vit)
Paketa e masave në sektorin e banesave	5	37	2693	19925
Paketa e masave në sektorin e shërbimeve	5	32	7345	47008
Paketa e masave në industri	6	42	13117	91816
Paketa e masave në sektorin e transportit	8	52	24680	160420
Paketa e masave në bujqësi	2	5	5448	13620
Direktiva e shërbimeve të energjisë (ESD) për kursimet totale të energjisë të parashikuara	26	168	53282	332789

Draftligji i ri “Për efikasitetin e energjisë” parashikon krijimin e një baze ligjore, që do të mundësojë dhe rregullojë të gjitha marrëdhëniet që do të lindin përgjatë procesit të zbatimit të masave të efikasitetit. Në ligj parashikohet të zbatohen të gjitha detyrimet e subjekteve të sektorit privat, publik etj. për të kryer auditimet energjetike, detyrimin për etiketimin e të gjitha pajisjeve elektroshtëpiake, plotësimin e kërkesave minimale mbi cilësinë termike, certifikimin e ndërtesave në sektorët e ndryshëm ekonomikë, krijimi dhe funksionimi i fondit të efikasitetit etj.

- Masat për implementimin e nenit 5 të direktivës 2006/32/EC: Efikasiteti i energjisë në sektorin publik

Shqipëria ka transpozuar ligjin mbi etiketimet e pajisjeve elektroshtëpiake. Direktiva e Bashkimit Europian 1992/75/EEC është transpozuar nëpërmjet ligjit nr.10 113, datë 9.4.2009 “Mbi informimin nëpërmjet etiketimit të standardeve për pajisjet elektroshtëpiake, që konsumojnë energji dhe burime të tjera”, duke siguruar detyrimin që kanë furnizuesit, që nëpërmjet fishave dhe etiketave, të garantojnë informacionet për këtë qëllim. Ligji siguron dhe bazën ligjore për transpozimin e direktivave të BE-së, të masave zbatuese nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave, të cilat janë në rrugën e draftimit të tyre.

Në PKVEE është prezantuar edhe detyrimi që ka sektori publik për të lehtësuar procesin e publikimit të guidave, mbi zbatimin e masave për përmirësimin e EE-së dhe kursimit të energjisë, si një kriter kyç në procesin e zhvillimit të tenderëve dhe kontratave publike.

-Masat për implementimin e nenit 7 të direktivës 2006/32/EC: Mbi vlefshmërinë (disponueshmërinë) e informacionit

Mungesa e informacioneve të përdoruesit fundor të energjisë në Shqipëri, është një çështje e ndjeshme dhe problematike.

INSTAT-i publikon çdo vit raporte, që lidhen me konsumin e burimeve energjetike. Gjithashtu, ERE publikon raporte vjetore mbi konsumet energjetike/të energjisë elektrike, çmimet e energjisë, projekte të ndryshme në zhvillim etj. AKBN-ja ka publikuar nëpërmjet website-it të saj bilancin energjetik, por nuk ka pasur publikime apo informime mbi efikasitetin e energjisë, masat për

përmirësimin e saj, programe, instrumentet financiare apo informim mbi kuadrin ligjor në proces, me qëllim që ta shpërndajë këtë informacion deri te konsumatorët fundorë.

Megjithatë, në draftligjin për “efiçencën e energjisë” përfshihen disa hapa të rëndësishëm për të mundësuar sigurimin e informacionit të nevojshëm për sektorin e energjisë, detyrimin për të raportuar në mënyrë periodike. Për këtë qëllim, kërkohet fuqizimi i kapaciteteve institucionale për të përmirësuar sistemin e raportimit në nivel rajonal dhe kombëtar.

- Masat për implementimin e nenit 11: Fondet dhe mekanizmat financiarë

Bazuar në nenin 11 të direktivës 2006/32/EC, PKVEE-ja ka në konsideratë financimin e investimeve të programeve të ndryshme, nëpërmjet aplikimit në fondin e efiçencës së energjisë nga aktorë të ndryshëm në fushën e energjisë, nga furnizues të burimeve të energjisë, nga konsumatorët, kompanitë e shërbimit etj. Fondi i efiçencës së energjisë është konsideruar të mbështetet dhe të financohet nga: buxheti i shtetit, donatorë të ndryshëm, zhvillues projektsh, investues, grante, hua nga bankat etj.

- Ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale

Rritja e kapaciteteve institucionale është mëse e nevojshme, me qëllim monitorim më të mirë të zbatimit të masave për përmirësimin e efiçencës së energjisë, e parë kjo nga këndvështrimi i PKVEE-së. Prandaj, ligji “Për efiçencën e energjisë” parashikon funksionimin e një strukture, me një staf të mirëpërgatitur, për menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor për efiçencën e energjisë dhe të planit kombëtar të veprimit të efiçencës së energjisë.

Direktiva 2005/32/EC, e cila shërben si udhërrëfyes për krijimin e kuadrit ligjor, për plotësimin e kërkesave për projektimin me efiçencë të të gjitha pajisjeve që konsumojnë energji, nuk është transpozuar akoma në Shqipëri. Sidoqoftë amendimi i kësaj direktive është një objektivi për ta transpozuar këtë direktivë në terma afatshkurtër.

Sidoqoftë, janë transpozuar/adoptuar disa vendime të Këshillit të Ministrave, që lidhen direkt me masat zbatuese; për llambat efiçente, efiçenca për frigoriferët, ngrirësit, bolierët etj.

- Koha e parashikuar për adoptim

Masat implementuese – Etiketimet energjetike (2011-2012), Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) do të finalizojë transpozimin e vendimeve, që kanë si bazë:

- Direktivën 2002/40/EC për etiketimin e furrave;

- Direktivën 2002/31/EC për etiketimin e makinave larëse.

Në terma afatmesëm (2011-2012) METE do të finalizojë adoptimin e vendimeve mbi:

- Direktivën 2003/66/EC për etiketimin e frigoriferëve, ngrirësve elektrikë apo dhe kombinimeve të tyre;

- Direktivën 1999/9/EC për etiketimin e makinave pjatolarëse;

- Direktivën 96/60/EC për etiketimin e makinave larëse dhe tharëse;

- Direktivën 98/11/EC për etiketimin e llambave efiçente;

METE ka parashikuar të transpozojë direktivën 2009/125/EC përgjatë vitit 2011.

Në zbatimin e ligjit të përmendur më sipër dhe të adoptimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave, që priten të bëhen në të ardhmen, do të bëhet i mundur zbatimi i kërkesave për përmirësimin e efiçencës së energjisë sidomos në sektorin publik:

- Plotësimi i kërkesave për blerjen e pajisjeve efiçente, bazuar në listspecifikimet efiçente;

- Shfrytëzimi me efiçencë e pajisjeve, duke përfshirë të gjitha mënyrat (edhe në stand-by);

- Plotësimi i kërkesave për zëvendësimin apo furnizimin e pajisjeve/mjeteve më efiçente;

- Plotësimi i kërkesave për kryerjen e auditimeve energjetike dhe zbatimin e masave me kosto efektive.

### 3.1 Llogaritja e objektivave

Objektivat e kursimeve janë llogaritur në bazë të konsumit mesatar final të energjisë për 5 vitet e fundit, për të cilat disponohen të dhëna nga bilancet vjetore të energjisë. Në rastin e Shqipërisë, kjo periudhë i takon viteve 2004-2008. Kalkulimi i objektivave për kursimin e energjisë është bërë me anë të metodologjisë të dhënë në aneksin 1, në përputhje me direktivën 2006/32/EC. Treguesit (objektivat) janë shprehur në vlerë absolute (Ktoe) për të qenë në harmoni me statistikat kombëtare.




Figura 4: Konsumi final energjetik 2004-2008 (Ktoe)

Tabela 6. Llogaritja e objektivave kombëtarë të kursimit të energjisë

Bilancet energjetike/konsumi final energjetik	2004	2005	2006	2007	2008
Konsumi final energjetik Ktoe	2063	1966	1763	1711	1841
Konsumi final energjetik në kuadër të direktivës Ktoe	2063	1966	1763	1711	1841
Industria (ESD)	249.6	243	235	254	230
Transport	901	871	798	723	811
Residencial	529.6	521	452	423	430
Shërbimet	235	206	144	107	194
Bujqësia	147.8	125	134	204	176

Siç shihet në figurën 4 dhe në tabelën 6, gjatë periudhës afatmesme, sektori i banesave do të jetë sektori që do të ketë një kontribut të madh në kursimin e energjisë, pas atij të transportit. Kjo është dhe arsyeja që ky sektor karakterizohet nga masa të shumta për përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Përcaktimi i objektivit me 22%, brenda objektivit të përgjithshëm për sektorin e banesave, rrjedh nga fakti që deri më tani janë ndërmarrë një sërë veprimesh nga METE, donatorë të ndryshëm, si dhe kuadri ligjor, që është në procesin e përmirësimit. Gjithashtu, sektori i banesave prezanton sektorin më të studiuar nga pikëpamja e potencialeve për kursimin e energjisë.

Sektori i shërbimeve përfshin një spektër të gjerë të konsumatorëve dhe të përdorimit të të gjithë burimeve të energjisë. Ky sektor përfshin: shëndetësinë, arsimin, shërbimet publike, objektet kulturore dhe sportive, kopshtet, çerdhet, turizmin etj. Me gjithë pjesëmarrjen reale të këtij sektori në konsumin e përgjithshëm të energjisë me 8.8%, objektivi i parashikuar për kursimin energjetik është 19% e objektivit të përgjithshëm, për shkak të masave të parashikuara dhe detyruese për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat private dhe në rritjen e përdorimit të pajisjeve elektroshtëpiake efikente. Deri tani janë zbatuar masa në nxitjen e përdorimit të energjisë diellore në ndërtesat e ndryshme komerciale dhe publike.

Industria, transporti dhe bujqësia parashikohet të kontribuojnë për arritjen e vlerës së parashikuar të kursimit të energjisë në masën 59% përkundëjt totalit të përgjithshëm 168 Ktoe në

vitin 2018. Megjithatë, një vështrim i përgjithshëm i situatës së konsumit të energjisë në këta sektorë, tregon që ka akoma shumë hapësirë për përmirësimin e kursimit të energjisë. Periudha e parë trevjeçare nuk parashikon masa tepër ambicioze, meqenëse të tre sektorët akoma nuk janë trajtuar thellësisht, në aspektin e vlerësimit të potencialeve për efikasitetin e energjisë. Këta tre sektorë konsiderohen të jenë më të mirë si objekt i fushatave promovionale të ndërgjegjësimit publik, sesa si objekt i masave konkrete detyruese. Për këta sektorë nevojitet kohë e konsiderueshme për krijimin e instrumenteve dhe mekanizmave të nevojshëm, me qëllim rritjen e ndikimit direkt të tyre në përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Sektorët e sipërpërmendur janë konsideruar të jenë objekt i fushatave promovionale dhe sensibilizuese.

Në figurën 5 paraqiten të përmbledhura kursimet relative dhe absolute të energjisë për secilin sektor ekonomik, me qëllim arritjen e objektivit të përcaktuar në paragrafët e përmendur më sipër.




Figura 5. Kursimet kumulative të efikasitetit të energjisë për çdo sektor (Ktoe)

### 3.2 Aspektet specifike të llogaritjes së objektivave për kursimin e energjisë

#### 3.2.1 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të konsumit final të energjisë

Llogaritja e konsumit final të energjisë bazohet në të dhënat statistikore të siguruara në vite, si dhe në bilancin vjetor të energjisë. Të dhënat për bilancin vjetor të energjisë janë siguruar nga prodhuesit dhe konsumatorët e energjisë: industria, transporti, banesat, shërbimet, bujqësia etj. Megjithatë, për sa i takon konsumit të energjisë në degë të ndryshme të ekonomisë, nevojitet sigurimi i të dhënave më të detajuara sipas nëndegëve apo komoditeteve që sigurojnë burimet e ndryshme të energjisë. Për këtë qëllim, janë përgatitur disa pyetësorë, të cilët përdoren për sigurimin e të dhënave të nevojshme në sektorin e banesave dhe të industrisë.

Vlerësimet e masave individuale të përmirësimit të efikasitetit të energjisë janë realizuar duke përdorur vlerësimet e ekspertit dhe disa studime, që janë bërë në mënyrë specifike për sektorin e banesave dhe të shërbimeve. Një kontribut shumë i vlefshëm ka qenë dhe eksperiencia ndërkombëtare e siguruar nga studimi “Planifikimi rajonal i vendeve të Europës Juglindore”. Këto të dhëna janë përdorur për të vlerësuar kursimet e mundshme të energjisë, që mund të sjellin masat e parashikuara për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

Të dhënat e ndryshme statistikore, të siguruara mbi konsumin final të energjisë, janë përdorur për llogaritjen e objektivave të kursimit energjetik. Të dhënat janë siguruar nga institucione dhe kompani të ndryshme, që operojnë në fushën e energjisë dhe konkretisht nga:

Bilanci energjetik vjetor i AKBN-së, Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), ministritë e ndryshme, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Ministria e Financave, nga e cila sigurohen të dhënat makroekonomike.

Duhet vënë në dukje se bilanci i energjisë është përcaktuar sipas metodologjisë së EUROSTAT-it, por në një format të sintetizuar dhe jo në formë të detajuar (pra në një format më të thjeshtë). Për t'u shënuar është fakti që tashmë ka të dhëna mbi sektorin e banesave, bazuar në kategoritë e ndryshme të tyre, si dhe janë siguruar disa të dhëna të vlefshme mbi sektorin e ndërtesave publike. Të dhënat e siguruar për sektorin e transportit, për sa i takon numrit të motorëve, kamionëve, autobusëve dhe minibusëve dhe të dhëna të tjera janë siguruar nga Ministria e Transporteve. Bazuar në të dhënat e INSTAT-it, janë siguruar të dhëna mbi numrin e banesave, numrin mesatar të njerëzve për banesë, të ardhurat e tyre, punësimet në sektorët publikë dhe privatë, bizneset kudo në vend (ndërmarrjeve) etj. Siç u përmend më sipër, ka akoma të dhëna të nevojshme që nuk janë siguruar për sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Për rrjedhojë nevojitet përmirësimi i statistikave të energjisë, sigurimi i të dhënave më të detajuara në sektorët ekonomikë të prodhimit dhe të konsumit, sipas komoditeteve energjetike.

Në funksion të zbatimit të PKVEE-së, është shumë e rëndësishme kërkesa për harmonizimin e kuadrit tonë ligjor me direktivat e BE-së dhe në mënyrë specifike hartimi (përmirësimi) i ligjit për efikasitetin e energjisë dhe akoma më e rëndësishme hyrja në fuqi dhe zbatimi i tij, me qëllim realizimin e PKVEE-së dhe veprimeve ambicioze të tij mbi efikasitetin e energjisë.

Ligji i "Efikasitetit të energjisë" dhe transpozimi në mënyrë më të plotë i direktivës 2010/30/EU (amendim i direktivës 92/75/EC) dhe direktivës 2006/32/EC, e 5 prillit 2006 mbi "Përdorimin me efikasitet të energjisë të përdoruesve fundorë dhe shërbimeve energjetike", do të ndihmojnë në hapat që do të ndërmerren nga të gjithë aktorët, që veprojnë në fushën e energjisë, si dhe në procesin e sigurimit të informacionit, auditimeve të energjisë dhe krijimit dhe funksionimit të fondit të efikasitetit të energjisë, duke përcaktuar strukturën përgjegjëse për problemet e efikasitetit të energjisë dhe monitorimin e procesit të implementimit të PKVEE-së.

### 3.3 Faktorët konvertues

Sikurse është paraqitur në PKVEE, të gjitha të dhënat e përdorura për llogaritjen e objektivave të kursimit të energjisë kanë konsistuar në të dhënat e siguruar nga bilanci vjetor energjetike dhe të dhëna të tjera statistikore. Bilancet energjetike janë bazuar në të dhënat e burimeve energjetike për konsumatorët finalë, nga termat fizikë në terma të unifikuar energjie (toe), nëpërmjet përdorimit të faktorëve konvertues. Të dhënat hyrëse (inputet), për hartimin e bilanceve vjetore të energjisë janë siguruar nga AKBN-ja. Metoda dhe faktorët konvertues kanë mbetur të pandryshuar për të gjithë periudhën 5-vjeçare, për vlerësimin e të dhënave mbi konsumet finale të energjisë.

Shqipëria është duke aplikuar një mënyrë të thjeshtë të mbledhjes së të dhënave energjetike me statistikat e EUROSTAT. Përmbajtja energjetike e burimeve të energjisë do të jetë e bashkëngjitur si aneks.

### 4. Prezantim i masave të efikasitetit të energjisë në sektorët e ekonomisë

Ky kapitull përmban një përmbledhje të masave të efikasitetit të energjisë në të gjithë sektorët.

Llogaritjet mbi masat individuale të përmirësimit të efikasitetit të energjisë janë bërë mbi bazën e disa vlerësimeve, nga të dhënat e disponuara për sektorin energjetik dhe vlerësimeve mbi bazë ekspertize.

#### 4.1 Masat për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sektorin e banesave

Sipas të dhënave të bilanci energjetik të vitit 2008, sektori i banesave konsumon më shumë se 23% të konsumit total final të burimeve energjetike. Sektori i banesave ka konsumin më të madh të energjisë elektrike përkundrajt sektorëve të tjerë me 47%. Format dominuese të energjisë në konsumin familjar janë energjia elektrike (47%), drutë e zjarrit (42%) dhe nënproduktet e naftës 10% (GLN).

Politikat energjetike për sektorin e banesave karakterizohen nga një sërë instrumentesh, që duhen aplikuar në aspekte të ndryshme të përdorimit të energjisë në banesa. Këto instrumente kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi përdorimin me efikasitet dhe kursimin e energjisë, si dhe në adresimin e rregullave për ndërtimin e ndërtesave të reja dhe rinovimin e tyre. Me objektivin për reduktimin e konsumit të energjisë sipas normave të përcaktuara më sipër, më poshtë jepen masat kryesore sasiore dhe cilësore, që nevojiten të merren në konsideratë për vitet në vazhdim:

1. Izolimi termik i stokut ekzistues të banesave, që do të kontribuojë në reduktimin e energjisë elektrike dhe druve të zjarrit për ngrohjen e hapësirave të banimit, në kuadër të aplikimit të kërkesave minimale mbi cilësinë termike të ndërtesave të reja dhe atyre ekzistuese.

2. Njohja dhe përdorimi i skemave të ngrohjes qendrore dhe lokale, që do të kontribuojnë në ngrohjen e hapësirave dhe ujit të ngrohtë sanitar, veçanërisht në ndërtesat e reja shumëkatëshe.

3. Përdorimi i sistemeve diellore për plotësimin e kërkesës për energji me ujë të ngrohtë sanitar, i cili do të reduktojë konsumin e energjisë elektrike të përdorur për këtë qëllim.

4. Përdorimi i pajisjeve elektrike të etiketuara.

5. Përdorimi më i madh i llambave efçente, të cilat do të reduktojnë energjinë elektrike të konsumuar për ndriçim, në kuadër të ligjit për etiketimin e pajisjeve shtëpiake.

Në paragrafët e mëposhtëm jepet në detaje secila nga masat e efçencës së energjisë dhe kursimet e energjisë për çdo rast. Masat afatshkurtra, të parashikuara gjatë periudhës 2011-2012, marrin parasysh faktin që nuk do të sigurojnë një efekt të menjëhershëm, sidomos në kursimet e kërkesës për ngrohje të hapësirave të banimit.

Në figurën 6 përmblihet në terma relativë kursimi i energjisë për sektorin e banesave, me qëllim arritjen e objektivit të përcaktuar në paragrafët e përmendur më sipër.




Figura 6. Objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë të efçencës së energjisë për sektorin e banesave (%)

Tabela 7. Plani i veprimit për implementimin e masave për përmirësimin e efijencës së energjisë në sektorin e banesave

Kodi	Masat për PEE-në	Elementet e rëndësishme/hapat e implementimit të masave për PEE-në	Ndikimi i pritshëm si rrjedhojë e veprimeve të PEE-së	Kursimet e pritshme të energjisë	Afati kohor për zbatimin e masave	Kostot e nevojshme për zbatimin masave të EE-së të mbuluara nga fondet publike për të gjithë periudhën (euro)	Vlerësimi makroekonomik (përfitimet)
	[Instrumentet politike, p.sh. çfarë masash janë planifikuar për të mundësuar veprimet për përmirësimin e efijencës së energjisë në këtë sektor]	[Përshkrim i detajuar i masave që mundësojnë PEE-në]	[Përshkrim se si masat ndihmëse ndikojnë në planet konkrete]	[Kursimet në kuadër të direktivës së shërbimeve energjetike, të cilat lidhen direkt me veprimet dhe indirekt me masat ndihmëse]	[Periudha kohore për implementimin e politikave dhe jo të impaktit]	[Përfshihen vetëm kostot nga fondet publike, jo kostot totale të veprimeve të PEE-së]	[A është ekonomikisht i zbatueshëm veprimi i PEE-së i planifikuar? A ka efekte ekonomike anësore negative ose pozitive?]
PEE-ja në sektorin e banesave/ndërtesës me një banesë të vetme (NDNJB)							
Ky seksion përmban masat ndihmëse të planifikuara për PEE-në në sektorin e banesave në një ndërtesë me një banesë (apartament). Për më shumë transparencë, instrumentet janë strukturuar sipas impaktit të tyre kryesor të menduar për:							
<ul style="list-style-type: none"> <li>- PEE-ja në ndërtimet e reja</li> <li>- PEE-ja në rinovimin e plotë të ndërtesës</li> <li>- PEE-ja në fazën e ndërtimit</li> </ul>							
	Plotësimi i kërkesave minimale për cilësinë termike të ndërtesave me një banesë të rikonstruktuar	Duke filluar nga kodi ekzistues i ndërtesës, janë rishikuar kërkesat minimale dhe do të përfshihen rregulla strikte për respektimin e vlerës së koeficientit të humbjeve volumore të nxehtësisë (Gv-së), si dhe për respektimin e kërkesës minimale për ngrohje dhe ftohje.	Respektimi i kërkesave minimale dhe përforcimi i aplikimit të kërkesave minimale do të përmirësojnë efijencën e energjisë së NDNJB-ve të rikonstruktura të paktën 5-10% deri në vitin 2012, kryesisht duke respektuar më mirë cilësinë e pjesës mbështjellëse të ndërtesës	(6 Ktoe)	2011-2018 Duke filluar nga 2011	Kosto të ulëta të buxhetit për të projektuar një kod të ri ndërtesash (punonjësit e shtetit) 10,000	Për shkak të angazhimeve kryesore afatgjata për strukturat e ndërtesave, efijenca e përmirësuar e energjisë të ndërtesave me një banesë të rikonstruktuar mund të shihet si me vlerë më të lartë ekonomike
	Përmirësimi i implementimit të kërkesave minimale për ndërtesat me një banesë	Përmirësimi i zbatimit të kodit të ndërtesave dhe ligjit “Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa” (Kërkesat minimale ekzistojnë aktualisht, por zbatimi i tyre në praktikën e ndërtimit mbetet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë procesi i nxjerrjes së lejes së ndërtimit kërkon përmirësim nga pikëpamja e respektimit të tij. Zhvillimi i një sistemi të përmirësuar kërkon përgatitje të mëtejshme dhe pjesëmarrjen aktive të bashkive të vendit.			2011-2018	Punonjës shtesë për të kontrolluar kërkesat e efijencës së energjisë në ndërtesa (buxheti i bashkisë) (200,000)	
	Paketë instrumentesh promovionale për instalimin e paneleve diellore për ujin e	Mundësia e aplikimit të kredive për të mundësuar blerjen e paneleve diellore dhe trajnimi i instaluesve të tyre	Përdorimi i paneleve diellore (Promovimi kërkon një rritje të përdorimit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit në NDNJB-të dhe sjell	(3 Ktoe)	Duke filluar nga 2011	Buxhet shtesë për informacion dhe trajnim. (50,000) (Kredi prej 4,5 milionë	Në varësi të kushteve fillestare, ndërrimi i bolierëve elektrikë me panele diellore

	ngrohtë në banesa		si rezultat reduktim të përdorimit të energjisë elektrike për ujë të ngrohtë			USD (tashmë e siguruar nga EBRD dhe bankat lokale për pronarët privatë)	vetëshlyhet nga 3-8 vjet
PEE-ja në sektorin e banesave/ndërtesë më shumë banesa (NDSHB)							
Ky seksion përmban masat ndihmëse aktuale të planifikuara për PEE-në në sektorin e ndërtesave me shumë banesa (apartamente). Për sa më shumë transparencë, instrumentet janë strukturuar sipas impaktit të tyre kryesor të menduar për: <ul style="list-style-type: none"> <li>- PEE-ja në ndërtimet e reja</li> <li>- PEE-ja në rinovimin e plotë të ndërtesës</li> <li>- PEE-ja në fazën e ndërtimit</li> </ul>							
	Kërkesat minimale për cilësinë termike të ndërtesat me shumë banesa (NDSHB) të rikonstruara	Kërkesat minimale janë rregulluar në Kodin e ndërtesave. Kërkesat minimale përfshijnë rregulla dhe norma për vlerën e koeficientit të humbjeve volumore të nxehtësisë (Gv-së), si dhe rregulla për respektimin e kërkesës minimale për ngrohje dhe ftohje	Respektimi i kërkesave minimale dhe forcimi i aplikimit të kërkesave minimale do të përmirësojnë efikasitetin e energjisë së NDSHB-së duke respektuar më mirë cilësinë e mbështjellës së ndërtesës nga pikëpamja termike.		2011-2018	Projektimi i projekteve (Nuk parashikon kosto)	Standartet e larta të efikasitetit të energjisë janë ekonomiksht të zbatueshme duke pasur parasysh jetëgjatësinë e ndërtesës. Targetet e kursimeve në sektorin e NDSHB-së mund të jenë më të larta sesa në sektorin e NDNJB-së sepse kostot ekstra të efikasitetit të energjisë mund të jenë më të thjeshta për t'u mbuluar në sektorin e NDSHB-së.
	Përmirësimi i implementimit të kërkesave minimale për NDSHB-në	Kërkesat minimale ekzistojnë aktualisht, por transpozimi i tyre në praktikën e ndërtimit mbetet mbrapa. Për rrjedhojë procesi i nxjerrjes së lejes së ndërtesës duhet përmirësuar. Zhvillimi i një sistemi të përmirësuar kërkon përgatitje të mëtejshme duke përfshirë dhe pjesëmarrjen e bashkive të vendit.	Termoizolimi i mbështjelljes së ndërtesës; (termoizolimi i jashtëm i mureve, tarracës, dyshemesë, ndërrimi i dritareve, dyerve, futja e sistemeve ngrohëse/ftohëse	(13 Ktoe)	2011-2018 (duke pasur parasysh disa procedura që duhen përcaktuar referuar trajnimin të stafit të bashkive	(200,000)	
	Implementimi i kuadrit të ri ligjor të kondominiumit	Harmonizimi me legjislacionin e BE-së, si dhe ligji për kondominiumet që janë për t'u aplikuar. (Kuai ligjor shqiptar për rinovimin e ndërtesave me bashkëpronarë është përmirësuar së fundmi duke parashikuar p.sh. pagesat mujore për të mbuluar fondet. Megjithatë, implementimi në praktikë mbetet mbrapa. Në këtë fushë ka nevojë të rritet informacioni dhe këshillimi.	Rinovimi i plotë termik i NDSHB-së është i leverdishëm përderisa ligji i banesave (kondominiumet) ofron një kuadër të favorshëm për rinovimin kryesisht të ndërtesave me bashkëpronarë.	(4 Ktoe)	2011-2018	(500,000) (nga Fondi i efikasitetit të energjisë për të gjithë periudhën)	Rinovimi i NDSHB-së është një sfidë mjaft e kushtueshme. Përveç efektit të kursimit të energjisë rinovimi gjithashtu, çon në përmirësim të dukshme të kushteve të jetesës.
	Skemat subvencionale për rinovimin total të SHSHF-së	Paraqitja e skemave subvencionale: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sigurimi i cilësisë minimale termike për të bërë të mundur sigurimin e subvencioneve;</li> <li>- Rritje të mundësisë për të siguruar subvencion nëpërmjet</li> </ul>	Historikisht, ndërtesat në Shqipëri konsistojnë në NDSHB-në. Pronarët nuk janë të aftë të mbulojnë të gjitha shpenzimet për rinovimin total të NDSHB-së, e cila normalisht është një pengesë për rinovimin ose që çon në rinovim me cilësi të ulët. Si pasojë, skemat subvencionale janë instrumente të rëndësishme për rritjen		Implementimi do të përgatitet në 2-3 vitet e ardhshme.	Instrument politik i kushtueshëm por i domosdoshëm për rinovimin e NDSHB-së  (50,000) (kontribuar nga FEE-ja)	



		<p>përmirësimin të cilësisë termike pas rinovimit (në rastet kur ndodh);</p> <p>- Në sektorin e kondominiumit: mbështetje ekonomike shtesë për ndërtesat e vjetra</p>	e ritmeve të rinovimit termik të tyre.				
PEE-ja në fushën e pajisjeve elektroshtëpiake në banesa							
Ky seksion përfshin masat ndihmëse të planifikuara për PEE-në për konsumin e energjisë (kryesisht konsumi i energjisë elektrike) të pajisjeve elektroshtëpiake (kondicionerët dhe pajisjet e tyre etj.)							
	Legjislacioni dhe implementimi i kuadrit ligjor për etiketimin e pajisjeve elektroshtëpiake	Etiketimi i pajisjeve elektroshtëpiake dhe i të gjitha pajisjeve të tjera energjetike sipas klasës së efikasitetit bazuar në standardet europiane (klasat A-B): makinat larëse, frigoriferët, sobat, pjatolarëset, pajisjet e kondicionerëve, bolierët elektrikë, llambat	<p>Përqindja e produkteve të etiketuara sipas klasave A dhe B rrit përqindjet e tyre në treg krahasuar me pajisjet më pak eficiente që çojnë në kursime të konsiderueshme të energjisë.</p> <p>Detyrimet e aktorëve të fushës së energjisë – për të siguruar informacione statistikore klientëve fundorë nga institucionet përgjegjëse të EE-së;</p> <p>Kërkesat për të blerë pajisje dhe mjete bazuar në specifikimet e produkteve eficiente të kategorive të ndryshme të pajisjeve dhe mjeteve; (prokurimet publike)</p>	Vlerësimi bazuar në efikasitetin mesatare pas implementimit krahasuar me statusin aktual dhe numrin e pajisjeve të shitura për çdo vit; (8 Ktoe)	2011-2018	(90,000)	Kosto marginale e pajisjeve më eficiente është shumë shpejt e vetëshlyeshme si rezultat i kursimeve të energjisë (periudha e vetëshlyerjes 1-3 vjet)
	Futja e standardeve minimale për pajisjet elektroshtëpiake	<p>Direktiva 2010/30/EU (përmirësimi i direktivës 92/75/EC) përshkruan një guidë udhërrëfyese për respektimin e vlerave minimale të konsumit energjetik, nëpërmjet etiketimit dhe informacioneve për standardet e produkteve dhe të gjitha atyre pajisjeve që janë të lidhura me transformimin e burimeve energjetike.</p> <p>Kriteret e direktivës së mëparshme të etiketimit të pajisjeve elektroshtëpiake (EuP) për pajisjet elektroshtëpiake është transpozuar, por del më se e nevojshme përshtatja me direktivën e re, që përfshin edhe pajisjet, teknologjitë etj.</p> <p>Për të gjitha burimet energjetike të përdorshme, dhe bashkë me të duhet të përfundojë hartimi dhe miratimi i kuadrit nënligjor dhe rregullator.</p> <p>Për të reduktuar kostot e testimit, fillimisht do të merren si të mirëqena rezultatet e testeve të standardeve të BE-së.</p>	<p>Pajisjet me efikasitet të ulët janë më pak të kërkuara në treg.</p> <p>Në treg vihet re rritje e kërkesës për pajisje eficiente</p>				
Masat ndihmëse për PEE-në me ndikim ndërsektorial							

Ky seksion përmban masat ndihmëse për PEE-në që kanë një ndikim ndërsektorial, p.sh. fushatat informuese, trajnimet, prezantimet e skemave audituese për NDNJB-në dhe NDSHB-në etj.; këto instrumente kanë zakonisht një karakter mbështetës në krahasim me instrumentet e tjera më specifike të sektorëve. Si pasojë për këto masa të PEE-së është e vështirë të identifikohen kursimet specifike. Zakonisht është më mirë që të llogariten kursimet e pritshme vetëm në nivelin e sektorit, sepse këto llogaritje kursimesh janë direkt të lidhura me veprimet e PEE-së

	Fushata informuese për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sektorin e banesave	Do të realizohen një seri fushatash për efikasitetin e energjisë, me tematika të qarta (p.sh. ndriçimi eficient, përdorimi eficient i pajisjeve ftohëse/ngrohëse të ambienteve, efektet pozitive të rikonstruksionit të ndërtesave etj.). Fushatat mund të bëhen në bashkëpunim me partnerë biznesesh, si përdorues energjie, tregtare etj.	Fushatat e informimit kanë efekt të shumëfishojnë instrumentet specifike të sektorëve (të përshkruar më sipër)			Kostot mund të reduktohen nga bashkëpunimi me partnerët e biznesit (10,000)	
	Mjete këshillimi për energjinë	Implementimi i mjeteve të këshillimit për energjinë është një "hap" i nevojshëm për fushatat e informimit. Mjetet e informimit do të ndërtohen hap pas hapi. Në hapin e parë, qendrat e informimit për banesat do të ndërtohen në qytetet më të mëdha. Auditimet mund të organizohen në bashkëpunim me bashkitë dhe/ose njësitë e energjisë. Drafti i ligjit të efikasitetit të energjisë i parashikon auditimet e energjisë dhe certifikimet energjetike të banesave.	Në shumë raste, përmirësimet e efikasitetit të energjisë për përdoruesit fundor janë, gjithashtu, kosto eficiente, dhe shpesh pengesa kryesore është mungesa e informacionit dhe sensibilizimit. Këshillimet për energjinë ndihmojnë për rritjen e informacionit për veprimet e PEE-së dhe gjithashtu për instrumentet e tjera të përshkruara në sektorin e banesave.	[Zakonisht kursime jo specifike të energjisë, sepse impaktet janë tashmë të mbuluara nga vlerat e kursimeve sektoriale]	2011-2018	(30,000) (Kryesisht punonjës shtesë). Kostot mund të reduktohen nga bashkëpunimi me partneret e biznesit dhe mund të mbulohen pjesërisht nga projekte ndërkombëtare	
	Edukimi dhe trajnimi i mëtejshëm i profesionisteve	Për profesionistët në sektorin e ndërtimit (projektues dhe specialistë ndërtimi), do të zhvillohen kurse trajnimi. Veç kësaj, do të zhvillohen, gjithashtu, procedura licencimi si hapa të mëtejshëm trajnimi	Edukimi i mëtejshëm i specialistëve të ndërtimit është një kusht për implementimin e veprimeve të PEE-së në sektorin e banesave.		2011-2018	(30,000) (Kosto për zhvillimin e kurseve të trajnimit) Mund të jenë pjesërisht të mbuluara nga projekte ndërkombëtare	
Nga sektori i banesave	Certifikimi i banesave	Në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues (Kodi Energjetik i Banës dhe ligji i efikasitetit të energjisë), do të paraqitet një skemë për certifikimin e ndërtesës në mënyrë që të bëjë konsumin e energjisë së ndërtesave të banimit më transparent për klientin dhe/ose banorin	Në terma afatgjatë, është e pritshme që certifikimi i ndërtesës të ndikojnë në vlerësimin real të tregut, kështu që mund të shiten më shumë ndërtesa eficiente me kushte më të mira dhe si rrjedhojë investitorët tentojnë të ndërtojnë ndërtesa më të mira në bazë të standardeve minimale.	(2 Ktoe)	Parashikohet të startojë në vitin 2012	Buxhet për edukimin e audituesve dhe vendosjen e skemës së certifikimit (jo investim publik)	Zbatimi afatgjatë i certifikimit të ndërtesave varet nga pranimi i tyre në treg

Tabela 8. Përshkrimi i masave individuale për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në sektorin e banesave

<b>Emri</b>	Plotësimi i kërkesave minimale nga pikëpamja energjetike në ndërtesat e reja dhe ato ekzistuese
<b>Kategoria</b>	Rregullator
<b>Aplikimi</b>	Kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Ekspertë nga institucionet shtetërore dhe private; hartues dhe zhvillues projektesh, arkitektë, prodhues materialesh ndërtimi dhe izoluese, tregtarë pajisjesh energjetike (prodhues dhe përdorues të këtyre burimeve të energjisë), pronarë banesa/ndërtesa, përfaqësues të bashkive, kompani shërbimi në fushën e energjisë (ESCO-s)
<b>Rezultatet, ndikimet te përdoruesit fundorë si rrjedhojë e PEE-së</b>	Zbatimi i Kodit të Banesave përfshin në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikimin që sjellin teknologjitë e përparuara të prodhimit të materialeve të ndërtimit, si: tullat, dritaret, dyert, materialet izoluese, tregtarët e llabave eficientë, pajisjeve elektroshtëpiake etj.
<b>Efektshmëria</b>	Përforcimi i zbatimit të Kodit të Banesave dhe përmirësimi i tij përfaqëson një mjet shumë efektiv, me shumë ndikim pozitiv në reduktimin e konsumit të energjisë në banesa dhe rritjen e komfortit të jetesës. Zbatimi i kuadrit ligjor për këtë qëllim pritet të gjejë më shumë zbatim duke filluar nga viti 2011
<b>Kursimi i pritshëm i energjisë në vitin 2018</b>	Potenciali i kursimit të energjisë nga zbatimi i kësaj mase vlerësohet të jetë: 21 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit të masës dhe koha e saktë e përfundimit</b>	Ekziston dhe zbatohet pjesërisht Kodi Energjetik në banesa që nga viti 2003, ligji i “Ruajtjes së nxehtësisë në banesa” i adoptuar me nr. 8937, datë 12.9.2002. Nuk kemi akoma zbatim të ligjit të “Efikasiteti i energjisë”, i prillit të vitit 2005

<b>Emri</b>	Fushatat informuese
<b>Kategoria</b>	Dhënia e informacioneve
<b>Aplikimi</b>	Kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Pronarët e banesave, tregtuesit, marrësit me qira, ndërtues, projektues, arkitektë etj.
<b>Rezultatet te përdoruesit fundorë si rrjedhojë e PEE-së</b>	Rritja e vetëdijshmërisë për kursimin e energjisë dhe ndryshimi i sjelljes së konsumatorit ndaj konsumit, duke sjellë reduktim të konsumit energjetik pa prekur cilësinë e shërbimeve energjetike
<b>Efektshmëria</b>	Fushatat informuese do të aplikohen në të gjithë vendin dhe në të gjitha zonat e tij për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit kundrejt përdorimit me efikasitet të saj. Fushatat do të përqendrohen drejt nxitjes së zbatimit të termoizolimeve eficientë, ndriçimit eficient, blerjes së pajisjeve elektroshtëpiake/energjetike eficientë etj.
<b>Kursimet e pritshme të energjisë në vitin 2018</b>	Potenciali për kursimin e energjisë nga zbatimi i kësaj mase parashikohet të jetë në nivelin 1 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit të masës dhe koha e saktë e përfundimit</b>	Fushatat informuese për rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës ka filluar që në vitin 2007 nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Qendra e Efikasitetit të Energjisë. Ky është një proces në vazhdim

<b>Emri</b>	Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në fushën e pajisjeve elektroshtëpiake dhe i të gjitha pajisjeve të tjera që përdorin burime të tjera energjetike ose prodhojnë/transformojnë energji
<b>Kategoria</b>	Masat që duhen ndërmarrë për detyrimin e informimit dhe etiketimit të pajisjeve elektroshtëpiake/energjetike
<b>Aplikimi</b>	Kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Pronarët e banesave, tregtarët, inspektoriatet kontrolluese me detyrë survejimin e tregut për zbatimin e ligjit mbi etiketimet, prodhuesit
<b>Rezultatet te përdoruesit fundorë si rrjedhojë e PEE-së</b>	Rritja e pjesës së tregut të pajisjeve eficientë elektroshtëpiake/energjetike
<b>Efektshmëria</b>	Skemat e etiketimit të pajisjeve elektroshtëpiake tashmë janë prezantuar në tregun shqiptar edhe pse jo në nivel të kënaqshëm apo të pritshëm. Kjo masë duhet të jetë objekt kontrolli nga strukturat përgjegjëse (Departamenti për Mbikëqyrjen e Tregut (METE) dhe do të shoqërohet me përdorim eficient të burimeve energjetike)
<b>Kursimet e pritshme të energjisë në vitin 2018</b>	Kursimi i pritshëm parashikohet të jetë në nivelin e 8 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit të masës dhe koha e saktë e përfundimit</b>	Legjislacioni është në fuqi që nga viti 2009. Është në pritje të adoptohet kuadri sekondar dhe rregullator dhe pritet një rezultat më konkret dhe për më tepër del e nevojshme adoptimi i direktivës së re 2010/31/EU në kushtet e Shqipërisë

<b>Emri</b>	Mbështetja financiare për zbatimin e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë
<b>Kategoria</b>	Instrumente financiare /subvencionime
<b>Aplikimi</b>	Kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Pronarët e banesave, institucionet financiare, donatorë, kompanitë e shërbimit energjetik, instaluesit e paneleve diellore/pajisjeve të tjera, fond i efikasitetit etj.
<b>Rezultatet te përdoruesit fundorë si rrjedhojë e PEE-së</b>	Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në banesa (termoizolim, ndryshim dritarësh, pajisje elektrike eficientë, përdorimi i paneleve diellore, pajisje eficientë të përdorimit dhe prodhimit të burimeve energjetike. Mbështetje financiare nga fondi i EE-së, kredi të buta, pjesëmarrje

	në treg e kompanive të shërbimit energjetik (Financim + Investim + Kursim) etj.
<b>Efektshmëria</b>	Reduktim i konsumit energjetik, përmirësim i të ardhurave duke ruajtur të njëjtin nivel komoditeti
<b>Kursimet e pritshme të energjisë në vitin 2018</b>	Kursimi i pritshëm vlerësohet të jetë 4 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit të masës dhe koha e saktë e përfundimit</b>	2011-2018

<b>Emri</b>	Pakete instrumentesh për instalimin e paneleve diellore për ujë të ngrohtë sanitar.
<b>Kategoria</b>	Promovim dhe mbështetje
<b>Aplikimi</b>	Rajonal
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Pronarët e banesave, prodhuesit e materialeve të ndërtimit, dyerve, dritareve, tregtuesit e pajisjeve elektroshtëpiake/dhe jo vetëm shtëpiake, kompanitë e shërbimeve, instalues të paneleve diellore etj.
<b>Rezultatet e përdoruesit fundorë si rrjedhojë e PEE-së</b>	Rritja e përdorimit të ujit të ngrohtë sanitar nga panelet diellore në banesa. Përdorimi i burimeve RES dhe zëvendësimi i konsumit të energjisë elektrike për nevoja të ujit të ngrohtë sanitar
<b>Efektshmëria</b>	Nxitja e kësaj mase çon në rritjen e përdorimit të energjisë diellore dhe zëvendësimin e konsumit të energjisë elektrike për të siguruar të njëjtin shërbim energjie
<b>Kursimet e pritshme</b>	Vlerësimi i kursimeve parashikohet 3 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit të masës dhe koha e saktë e përfundimit</b>	2011-2018

4.1.1 Vlerësimi i kursimit total të energjisë (ESD) në sektorin e banesave i parashikuar për periudhën 2011-2012 dhe 2012-2018.

Vlerësimi për kursimin e energjisë në sektorin e banesave për periudhën 2011 – 2012 dhe 2012 – 2018 është dhënë në tabelat e mësipërme. Ai bazohet në gjykimin e ekspertit dhe në disa llogaritje të masave të ndryshme të efikasitetit të energjisë, të implemtuara gjatë këtyre viteve, nëpërmjet projekteve pilot në Shqipëri apo në rajon.

Në përputhje me kërkesat e ESD-së, Shqipëria do krijojë sistemin për monitorimin dhe verifikimin e kursimit të energjisë.

Duhen bërë përmirësime në monitorimin e konsumit të energjisë në sektorin e banesave. Është e nevojshme të monitorohet numri i ndërtesave të banimit, sipërfaqja e hapësirave të banimit, numri i shtëpive dhe banesave, karakteristikat e termoizolimit, numri dhe llojet e pajisjeve, përfundimi i energjisë nga pajisjet, konsumi specifik i pajisjeve kryesore, popullsia/banesë etj. Gjithashtu, sistemi i mbledhjes së të dhënave do të përfshijë pyetësorët dhe vëzhgimet në familje.

Struktura përgjegjëse për monitorimin e matjeve dhe verifikimit të kursimeve të energjisë do të jetë METE nëpërmjet AKBN-së. Ecuria e këtij procesi do të raportohet dhe publikohet në mënyrë vjetore.

#### 4.2 Masat e përmirësimit të efikasitetit të energjisë në sektorin e shërbimeve

Sektori i shërbimeve përfshin sektorin e shërbimeve tregtare, duke futur këtu ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe sektorin publik. Sektori i shërbimeve përllogaritet të konsumojë afërsisht 6% të konsumit total final, në kuadër kjo të direktivës së shërbimeve energjetike (ESD). Energjia elektrike është burimi dominues i sektorit me 47% të konsumit e ndjekur nga nënproduktet e naftës me 33.7% dhe drutë e zjarrit 11%, dhe pjesa tjetër 7% nga qymyret dhe burime të tjera të energjisë.

Parashikimi për mundësinë e përmirësimit të efikasitetit të energjisë është 22% kundrejt kursimit total të energjisë për periudhën 2011-2018. Këto vlerësime janë bërë duke marrë në konsideratë faktin që në vitin 2012 do të startojë implementimi i ligjit për efikasitetin e energjisë, auditimet e energjisë, certifikimi energjetik i ndërtesave, funksionimi i fondit të efikasitetit etj. Sektori i shërbimeve publike përfshin zbatimin e masave të efikasitetit në ndërtesa, pajisjet elektroshtëpiake apo skema të tjera efikente për ngrohjen apo ventilimin e hapësirave.

Direktiva 2006/32/KE shpreh qartë faktin se sektori i shërbimeve publike luan një rol të rëndësishëm si pararojë e shembujve për të gjithë sektorët e tjerë për zbatimin e masave të efikasitetit. Për pasojë është vlerësuar që sektori i shërbimeve publike ka potenciale të dukshme për reduktimin e konsumit të energjisë në të ardhmen.

Masat që do të ndikojnë në reduktimin e konsumit të energjisë do të jenë rritja e çmimit të energjisë elektrike, implementimi i Kodit Energjetik të Ndërtesave në stokun ekzistues të ndërtesave publike dhe private, aplikimi i iniciativave fiskale për burimet e rinovueshme të energjisë dhe

burimet e tjera efçente, izolimi termik, ndriçimi efçent, pajisjet elektrike efçente, fushatat ndërgjegjësuere etj.

Masat më të rëndësishme jepen më poshtë:

- Depërtim i ndjeshëm i produkteve të gazit të lëngët të naftës për ngrohjen e hapësirave dhe kërkesës energjetike për ujë të ngrohtë;

- Përmirësim i izolimit termik në stokun e ndërtesave ekzistuese publike dhe private të sektorit të shërbimeve dhe aplikim rigoroz i Kodit të Energjisë në Ndërtesa, në ndërtesat e reja; Rregullore teknike mbi performancën energjetike të ndërtesave dhe zbatimi i tyre në praktikën e ndërtimit, zgjerim i përdorimit të sistemeve diellore për përgatitjen e ujit të ngrohtë në ndërtesat publike dhe tregtare të këtij sektori;

- Penetrim gradual i impianteve të vegjël CHP dhe skemat e ngrohjes qendrore për konsumatorët e mëdhenj e të vegjël (spitalet, konviktet, hotelet etj.), veçanërisht nëpërmjet zëvendësimit të sistemeve ekzistues konvencional;

- Kryerja e auditimeve energjetike në ndërtesat publike dhe private të sektorit të shërbimeve (spitale, konvikte, hotele etj.) dhe qendrat e mëdha tregtare dhe hoteleri; inspektimet e detyrueshme të ngrohjes, ventilimit dhe sistemeve të ajrit të kondicionuar dhe zbatimi i masave të efçencës së energjisë pas kryerjes së auditimeve.

Përmirësimi i efçencës në ndërtesat publike dhe private të sektorit të shërbimeve, nëpërmjet zbatimit të të gjitha masave, siç janë: rritje e përdorimit të ndriçimit efçent, përdorimi i teknikave inteligjente, përdorimi i pajisjeve elektrike moderne me cos ( $\Phi$ ) të përmirësuar në pompa, frigoriferë etj. Për konsumatorë të ndryshëm të sektorit të shërbimeve, aplikimi i vendosjes së etiketave në pajisjet elektrike, që përdoren në zyra, sipas klasave efçente, mbetet një nga detyrat kryesore për zbatimin e masave të efçencës.

- Njohja dhe funksionimi i kontratave të performancës energjetike.

- Fushata informacioni në nivel kombëtar dhe rajonal.

Në figurën 7 paraqitet ruajtja e energjisë në terma relativë për sektorin e shërbimeve, me qëllim arritjen e objektivit të përcaktuar në paragrafët e sipërpërmendur.




Figura 7. Kërkesa totale për energji pas masave efçente të implementuara në sektorin e shërbimeve në %.

Tabela 9. Plani i veprimeve për implementimin e masave për përmirësimin e efijencës së energjisë në sektorin e shërbimeve publike dhe private

Kodi	Masat ndihmëse për PEE-në	Elementet e rëndësishme/hapat e implementimit të masave ndihmëse për PEE-në	Impakti i pritshëm nga zbatimi i veprimeve të PEE-së	Kursime të pritshme të energjisë	Afati kohor për implementimin	Kosto e implementimit për buxhetet publike (euro)	Vlerësimi makroekonomik
	[Instrumente politike, p.sh. çfarë masash janë planifikuar për të thjeshtuar veprimet për përmirësimin e efijencës së energjisë në këtë sektor]	[Përshkrim i detajuar i masave të thjeshtuara për PEE-në]	[Përshkrim se si masat ndihmëse ndikojnë në planet konkrete]	[Kursimet janë të lidhura direkt me veprimet, dhe vetëm indirekt me masat ndihmëse]	[Periudha kohore për implementimin e politikave dhe jo të impaktit]	[Përfshin vetëm koston për buxhetet publike, jo koston totale të veprimeve të PEE-së.]	[A është veprimi i PEE-së i planifikuar ekonomikisht i zbatueshëm?]
PEE-ja për ndërtimet e reja në sektorin e shërbimeve private/ndërtesat në sektorin terciar (p.sh. dyqane, zyra etj.)							
Ky seksion përmban masat ndihmëse aktuale të planifikuara për PEE-në për ndërtimet e reja në sektorin e ndërtesave të shërbimeve							
	Standardet minimale për ngrohjen dhe ftohjen për ndërtesat e shërbimeve të rikonstruara	Rregullat teknike për të rritur performancën energjetike të ndërtesave përfshijnë standardet minimale për ngrohjen dhe ftohjen e ndërtesave të shërbimit (ndoshta të ndryshme sipas përdorimit të ndërtesës), të paktën për indikatorët e mposhtëm të performancës energjetike: kërkesën neto për ngrohje; kërkesën neto për ftohje.	Standardet minimale pengojnë ndërtesat me performancë të ulët energjetike; kursimet energjetike kryesisht të pritshme nga ngrohja dhe ftohja.	(6 Ktoe)	2011-2018	Jo kosto publike në sektorin privat	Standardet minimale për performancë të mirë energjetike janë ekonomikisht të preferueshme, sepse ato mund të çojnë në kosto më të ulët të mirëmbajtjes së ndërtesës. Rregullorja është e nevojshme sepse dilema e investitorit është një barrierë serioze për koston optimale.
	Përmirësimi i implementimit të kërkesave minimale për ndërtesat e shërbimeve private	Kërkesat minimale ekzistojnë aktualisht, por zbatimi i tyre në praktikën e ndërtimit mbetet mbrapa. Për rrjedhojë procesi i nxjerrjes së lejes së ndërtesës duhet përmirësuar. Zhvillimi i një sistemi të përmirësuar kërkon përgatitje të mëtejshme, duke përfshirë dhe pjesëmarrjen aktive të bashkive në këtë proces.			2011-2018	Staf nga bashkitë për të kontrolluar implementimin e këtij procesi (30,000)	
PEE-ja në ndërtesat ekzistuese të shërbimit privat							
Ky seksion përmban masat ndihmëse aktuale të planifikuara për PEE-në në ndërtesat ekzistuese të shërbimit privat							
	Implementimi i auditimeve të energjisë në ndërtesat e shërbimeve	Inspektime të detyrueshme të standardeve të sistemeve të ngrohjes, ventilimit të kondicionimit të ajrit (sipas kërkesave për performancën energjetike të ndërtesave) janë të kombinuara me auditime të plota energjetike, të cilat janë pjesërisht të subvencionuara (FEE).	Inspektimet e detyrueshme dhe auditimet energjetike janë në veprimet e propozuara për PEE-në. Do të implementohet një përqindje prej 30% e masave pa kosto ose me kosto të ulët. Duke iu referuar masave më të plota të rinovimit ne presim një përqindje implementimi vetëm 10-12%.	(8 Ktoe)	Duke filluar nga viti 2011 dhe përgjatë 2011 - 2018	(100,000)	

			(Termoizolim, inspektim bolierësh, përdorim të pompave të nxehtësisë, (kondicionerë), zëvendësim me pajisje efçente)				
PEE-në në sektorin publik (p.sh. ndërtesat e bashkive dhe të shtetit)							
Ky seksion përmban masat ndihmëse aktuale të planifikuara për PEE-në në sektorin e ndërtesave publike. Ky sektor duhet të shprehë modelin e funksionit të sektorit publik për sektorët e tjerë, duke pasur parasysh nenin 5 të ESD-së. Për sa më shumë transparencë, instrumentet janë strukturuar sipas impaktit të tyre kryesor të menduar për:							
<ul style="list-style-type: none"> <li>- PEE-në në ndërtimet e reja publike</li> <li>- PEE-në në rinovimin e plotë të ndërtesave publike</li> <li>- PEE-në në fazën e ndërtimit të ndërtesave publike</li> </ul>							
	Standarde të forta të efçencës së energjisë për ndërtesat e reja publike	Sektori publik duhet të ndërmarrë plotësimin e standardeve të energjisë më të lartë sesa standardet minimale të vlefshme të ndërtesave të shërbimit privat .	Këto standarde bëjnë të sigurt që ndërtesat e reja publike (administratë, shkolla, spitale, universitete etj.) të përdorin sa më pak energji të jetë e mundur.	4 Ktoe	2011-2018	Jo fonde publike	Standardet e larta për ndërtesat publike janë të preferueshme ekonomikisht, sepse ato çojnë në kosto më të ulët të mirëmbajtjes së ndërtesës.
	Program rinovimi për ndërtesat e shërbimit publik	Shteti merr përsipër të rinovojë ndërtesat me pronar shtetin duke ndjekur dhe plotësuar standardet e larta të energjisë. Ashtu si shteti, edhe bashkitë do të bëjnë rinovimet për ndërtesat e tyre të shërbimit publik. Marrëveshjet e performancës së energjisë përdoren për të siguruar cilësi të lartë të rinovimit dhe bashkëfinancim për zbatimin e masave për kursimin e energjisë.	Rinovimi i plotë i ndërtesave ekzistuese publike (administratë, shkolla, universitete, spitale etj.) zakonisht ofron potenciale të larta të kursimeve të energjisë ndërkohë, që në të njëjtën kohë përmirëson komfortin dhe cilësinë e vendit të punës në këto ndërtesa (termoizolim, inspektim bolierësh, përdorim të pompave të nxehtësisë, (kondicionerë), zëvendësim me pajisje efçente).	Reduktim të përdorimit të energjisë nëpërmjet rinovimit; 5 Ktoe	Mesi i viteve 2011-2018	1,000,000	Për arsye të jetëgjatësisë dhe disa herë të potencialeve të mëdha të kursimeve energjetike, shpeshherë masat që ndërmerrren në aspektin e zëvendësimeve efçente mund të rezultojnë të shlyera vetëm nëpërmjet nivelit të kursimeve. Përmirësimi i komoditetit, cilësisë së shërbimeve, konsiderohen si përfitime që rrjedhin nga rinovimi.
	Përdorimi i marrëveshjeve të performancave energjetike (KPE) për ndërtesat publike dhe ndriçimi rrugor i bashkive	Përdorimi i KPE-së në ndërtesat publike, siç janë: ato të edukimit, të kujdesit të shëndetit dhe në ndriçimin rrugor duke krijuar kontakte direkte me kompanitë e shërbimit në fushën energjetike për të ndërmarrë veprime zbatimi të masave të efçencës. Seminaret e fokusuar me grupe vendimmarrësish me targete të ndryshme: - Ndërtesat e edukimit (shkolla, kopshte, universitete): Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bashkitë; - Ndërtesat e kujdesit të shëndetit: Ministria e Shëndetit Publik	Për shkak të eksperiencave të përdorimit të KPE-së sidomos në ndërtesat publike dhe ndriçimin rrugor përbëjnë objekte ideale për këto kontrata. Një fushatë informimi dhe sensibilizimi për krijimin e kontakteve direkte me kompanitë e shërbimit për zhvillimin e projekteve të EE-së në shkolla, universitete, spitale etj. dhe në ndriçimin rrugor për bashkitë.	2 Ktoe	2011-2018	100,000	

		- Ndërtesat e administratës: bashkitë Ndriçimi rrugor: bashkitë.					
	Promovimi i paneleve diellore për ujin e ngrohtë sanitar	Zbatim i disa projekteve në lidhje me përdorimin e paneleve diellore për ujin e ngrohtë sanitar	Promovimi dhe mbështetja ligjore, rregullatorë, skema financimi, lehtësim nga detyrimet doganore etj. sjellin një rritje të penetrimit të paneleve diellore për ujin e ngrohtë në sektorin publik dhe privat.	2 Ktoe	2011-2018	30,000	
	Trajnimi të stafit të menaxhimit të ndërtesave lidhur me efikasitetin e energjisë	Program trajnimi për stafin e menaxhimit të ndërtesave për efikasitetin e energjisë, mirëmbajtjen nga ana teknike eficiente të ndërtesës, p.sh.: monitorim të konsumit të energjisë, evidentimi i kursimeve me kosto të ulët nëpërmjet përshtatjes së duhur të pajisjeve të ngrohjes, ftohjes, ventilimit, pompave të nxehtësisë, duke parë orët e punës, (sistemet "smart") etj.	Janë identifikuar dhe implementuar masa me kosto të ulët në stokun e ndërtesave publike.	2 Ktoe	Programi arrin 2-5 vjet për të përfshirë një numër të mjaftueshëm menaxherësh të ndërtesave 2011-2018.	5,000 Kostot për edukimin janë të ulëta krahasuar me kostot për kursimet e energjisë që mund të arrihen.	Kurset mund të vazhdojnë për operimin e ndërtesave të reja të shërbimit.
PEE-ja në fushën e pajisjeve elektrike në sektorin terciar të shërbimeve							
Ky seksion përmban masat ndihmëse aktuale të planifikuara për PEE-në për konsumin e energjisë (kryesisht konsumi i energjisë elektrike) të pajisjeve të zyrave (kompjuterë, monitorë, printerë, fotokopje, njësitë e kondicionerëve etj.)							
	Zbatimi kuadrit ligjor ekzistues për etiketimin e pajisjeve elektrike të zyrave. Dhe nevoja për adoptimin e drektivës 2010/30/EU	Transpozimi i direktivës 2010/30/EU (amendim i direktivës 92/75/EC), për respektimin e vlerave minimale të konsumit energjetik, nëpërmjet etiketimit dhe informacioneve për standardet e produkteve si e të gjitha atyre produkteve që janë të lidhura me transformimin e burimeve energjetike. Etiketimi i pajisjeve të zyrave sipas klasës së efikasitetit bazuar në standardet europiane, (Klasat A-G) dhe i të gjitha pajisjeve që përdorin jo vetëm energji elektrike.	Pjesa e produkteve të etiketuara në klasën A dhe B në treg është rritur në krahasim me pajisjet me pak efikasitet që çojnë në kursime të konsiderueshme të energjisë.	Vlerësimet për kursimet e parashikuara janë bazuar në: konsumin energjetik pas marrjes së masave të efikasitetit (në terma mesatare krahasuar me gjendjen aktuale, numri i pajisjeve të shitura në vit, por që duhet të bëhet vlerësim për çdo kategori produkti. 3 Ktoe		50,000	Kosto marginale e pajisjeve eficiente vetëshlyet nga kursimet (periudha e vetëshlyerjes 1-3 vjet)
	Rritja e penetrimit të pajisjet elektrike/ energjetike sipas standardeve të efikasitetit	Adoptimi i Direktivës 2010/30/EU për respektimin e vlerave minimale të konsumit energjetik, nëpërmjet etiketimit dhe informacioneve për standardet e produkteve dhe të gjitha atyre produkteve që janë të lidhura me transformimin e burimeve energjetike	Pajisjet me efikasitet të ulët janë tashme jo të kërkuara në treg. Si pasojë dhe cilësia nga pikëpamja e efikasitetit për pajisjet e zyrave është duke u përmirësuar.		2012-2018		
Masat ndihmëse për PEE-në në formë të kryqëzuar sektorale							
Ky seksion përmban masat ndihmëse për PEE-në që kanë një impakt ndërsektorial, p.sh. fushata informuese, trajnime, prezantime të skemave audituese; instrumente këto që kanë zakonisht një karakter mbështetës në krahasim me instrumentet e tjerë me specifik të sektorëve. Për pasojë, për këto masa të PEE-së është e vështirë të identifikohen kursimet specifike. Zakonisht është mirë të llogariten kursimet e pritshme vetëm në nivel sektori, sepse këto llogaritje kursimesh janë direkt të lidhura me veprimet e PEE-së							



Nga tabela e dytë	Fushatë informuese dhe sensibilizuese për përdoruesit	Fushata sensibilizimi në nivel kombëtar dhe rajonal dhe për sektorë specifike, p.sh. për ndërtesa me destinacion hotel. Fushatat do të fokusohen në veprime specifike të PEE-së, si përdorimi i sistemeve efçente të ndriçimit, termoizolimi ose përdorimi i paneleve diellore për ujin e ngrohtë, pajisjeve efçente. Këto fushata do të përdoren gjithashtu, për të prezantuar auditimet energjetike dhe trajnimet profesionale për menaxherët e ndërtesave (shih instrumentet më sipër).	Në shumë raste, përmirësimet e efçencës së energjisë për përdoruesit janë, gjithashtu, me kosto efçente dhe shpesh pengesat kryesore janë informacioni dhe sensibilizimi. Këto fushata do të rrisin ndjeshmërinë për të ndërmarrë veprimet për PEE-në të cilat ndihmojnë, gjithashtu, për të prezantuar instrumente të tjera.	Përfitimet vijnë në mënyrë graduale të shoqëruara edhe nga impaktet që sjellin zbatimi i masave të EE-së. (1 Ktoe)	Fushatat kanë filluar që në vitin 2008	Buxheti për fushatat 2,000	Kosto efektive e këtyre fushatave të informimit konsiderohet e lartë
Nga tabela e dytë	Certifikimi i ndërtesave	Në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues (Kodi Energjetik i Banesave dhe ligji (i ri) i efçencës së energjisë), do të paraqitet një skemë e cila do të jetë detyrim i shoqëruar me një dokument: Certifikata energjetike e ndërtesës e cila sjell një paraqitje transparente për konsumin energjetik në ndërtesa për klientin dhe/ose banorin	Në terma afatgjatë, është e pritshme që certifikatat e ndërtesës të ndikojnë në vlerësimin real të tregut, kështu që pajisja me këtë certifikatë mund të sjellë më shumë shitje të ndërtesave efçente dhe si rrjedhojë investitorët do të tentojnë të ndërtojnë ndërtesa ekonomike dhe efçente.		Planifikuar të fillojë pas mesit të vitit 2011	Buxhet për trajnimin e audituesve dhe vendosjen e skemës së certifikatës (jo investim publik)	Zbatimi afatgjatë i certifikatave të ndërtesave varet nga pranimi i tyre në treg

Tabela 10. Masat e PEE-së në sektorin e shërbimeve, përshkrim i masave individuale të PEE-së

<b>Emri</b>	Rregullore teknike mbi performancën energjetike në ndërtesa
<b>Kategoria</b>	Rregullore
<b>Aplikimi rajonal</b>	Kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Ekspertë nga institucionet shtetërore dhe private; hartues dhe zhvillues projektesh, arkitektë, prodhues materialesh ndërtimi, pronarë ndërtesash, përfaqësues të bashkive, kompani shërbimi në fushën e energjisë (ESCO), tregtarë të pajisjeve energjetike, prodhues të tyre etj.
<b>Përmirësimi EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Zbatimi i Kodit të Ndërtesave dhe certifikimi i ndërtesave, certifikimi i pajisjeve energjetike do të nxisin shpërndarjen e teknologjive të reja në lidhje me prodhimin e materialeve të ndërtimit si: dritare, dyer, materiale izoluese, tulla, do të nxisin tregtinë e llambave dhe të pajisjeve efçente etj.
<b>Efektiviteti</b>	Plotësimi i kuadrit ligjor dhe zbatimi i tij parashikon rezultate shumë pozitive për kursimin e energjisë dhe për rrjedhojë edhe kursim të të ardhurave monetare
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik në vitin 2011 dhe 2018</b>	12 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	Kodi ekzistues i ndërtesave ka nevojë të përmirësohet dhe të adoptohet në mënyrë më të plotë me direktivën e re 2010/30/EU. Është në proces draftimi i ligjit për efçencën e energjisë dhe legjislacioni sekondar i nevojshëm do të adoptohet sipas direktivave përkatëse të BE-së. Përshtatja e tyre parashikohet të përfundojë në fillim të vitit 2011.
<b>Emri</b>	Kontrolle të detyrueshme të pajisjeve të ngrohjes, ventilimit dhe të sistemeve të ajrit të kondicionuar
<b>Kategoria</b>	Realizimi i auditimeve të energjisë dhe zbatimi i masave për PEE-në, si dhe certifikimi i pajisjeve elektroshtëpiake nga pikëpamja energjetike
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Sektori privat, prodhuesit/tregtarët e pajisjeve elektroshtëpiake/termike, strukturat e licencuara për kryerjen e auditimeve të energjisë, strukturat përgjegjëse shtetërore për kontrollin e zbatimit të masave të EE-së, kompanitë e shërbimeve në fushën e energjisë (ESCO)
<b>Përmirësimi EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Rritja e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit për kryerjen e auditimeve dhe të investimeve në efçencën e pajisjeve të sipërpërmendura
<b>Efektiviteti</b>	Certifikimi i pajisjeve elektroshtëpiake/energjetike/ termike në përputhje me kuadrin ligjor (ligji për efçencën e energjisë dhe etiketimit) do të sjellin reduktimin e konsumit energjetik/kursimin energjetik, por kërkohet akoma plotësimi i kuadrit ligjor jo vetëm me kuadrin sekondar të ligjeve por dhe adoptimin e direktivës së re (të amenduar) të etiketimit, 2010/30/EU
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik në vitin 2011 dhe 2018</b>	11 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	Zbatimi i kuadrit ligjor dhe programeve të nevojshme për certifikimin e auditorëve dhe kryerjen e auditimeve të energjisë do të realizohen duke filluar nga viti 2011
<b>Emri</b>	Paketa e instrumenteve promovionale për instalimin e paneleve diellore në sektorin tercial
<b>Kategoria</b>	Nxiftja dhe përkrahja
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Rajonale
<b>Përmirësimi EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Sektori privat dhe publik
<b>Efektiviteti</b>	Përdorimi i burimeve RES, zëvendësimi i përdorimit të energjisë elektrike nga energjia diellore
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik në vitin 2011 dhe 2018</b>	2 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	Proces në vazhdimësi
<b>Emri</b>	Standardet energjetike për ndërtesat e shërbimit privat dhe publik (rinovimi i ndërtesave shoqëruar me rritjen e efçencës së energjisë)
<b>Kategoria</b>	Standardet energjetike në nivel kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Sektori privat, publik, prodhuesit/tregtarët e pajisjeve elektroshtëpiake/termike, strukturat e licencuara për kryerjen e auditimeve të energjisë, strukturat përgjegjëse shtetërore për kontrollin e zbatimit të masave të EE-së, kompanitë e shërbimeve në fushën e energjisë (ESCO), bashkitë, ndërtues, arkitektë, prodhues të materialeve të ndërtimit etj.
<b>Përmirësimi EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Zbatimi i të gjitha normave, rregullave, standardeve të miratuara që sjellin reduktimin e konsumit energjetik
<b>Efektiviteti</b>	Ndërtesat publike dhe private (administratë, shkolla, spitale, universitete etj.) konsumojnë më pak energji, më pak humbje, më pak shpenzim monetar, më shumë komoditet
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik në vitin 2011 dhe 2018</b>	5 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	Aktivitetet kanë startuar. Veprimet do të shtrihen nga viti 2011 e në vazhdim.
<b>Emri</b>	Informim dhe sensibilizim
<b>Kategoria</b>	Promovim
<b>Kategoria</b>	Informacion, detyrimi për informim, sensibilizim
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Sektori privat, publik, prodhuesit/tregtarët e pajisjeve elektroshtëpiake/termike, strukturat përgjegjëse shtetërore për informimin, kontrollin e zbatimit të masave të EE-së, kompanitë e shërbimeve në fushën e energjisë, bashkitë, ndërtues, arkitektë, prodhues të materialeve të ndërtimit, INSTAT
<b>Përmirësimi EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Sektori i shërbimit do të jetë më cilësor, me furnizim më të mirë energjie, rritje të komoditetit (shërbime energjetike)
<b>Efektiviteti</b>	Rritja e ndërgjegjësimit për kursimin e energjisë, përdorim i burimeve alternative të energjisë, të pajisjeve më efçente, ndryshim i sjelljes së konsumatorëve ndaj konsumit, menaxhimi më i mirë i përdorimit të burimeve
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik në vitin 2011 dhe 2018</b>	2 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	Procesi është në zhvillim

4.2.1 Vlerësimi i ruajtjes totale të energjisë ESD në sektorin e shërbimeve/terciar i parashikuar për periudhën 2011-2012 dhe 2012-2018

Llogaritjet bazohen në të dhënat ekzistuese dhe në disa vlerësime e supozime ekspertësh.

Në mënyrë të veçantë duhet thënë se, aktualisht, nuk jepet qartë konsumi i energjisë nga ndërmarrjet tregtare dhe shërbimet publike. Kjo gjë kërkon një implementim korrekt të kuadrit ligjor, në lidhje me auditimet energjetike, të informacioneve të siguruara, investimet në efikasitetin e energjisë etj.

4.3 Masat e përmirësimit të efikasitetit të energjisë në sektorët e industrisë

Sektori i industrisë llogaritet që të konsumojë afërsisht 13% të totalit të konsumit final të energjisë në vitin 2008.

Konsumatori më i madh i burimeve të energjisë është dega e industrisë ushqimore me 19.9%, sektori i materialeve të ndërtimit me 18.6%, i ndjekur nga industria kimike me 15.4%, industria e nxjerrjes së hekurit 12.5% etj.

Struktura e konsumit të burimeve të energjisë për degën e industrisë paraqitet si më poshtë: lëndë djegëse të ngurta 1.7%, biomasa 11.7%, produktet e naftës 64.4% dhe energjia elektrike 22.2% etj. Parashikimi i konsumit të energjisë për 2011-2018 tregon rritje të konsumit të energjisë në sektorin e industrisë, thuajse me 100 Ktoe krahasuar me vitin 2008.

Në draftin e ligjit “Për efikasitetin e energjisë” duhet parashikuar që sektori i industrisë duhet audituar dhe të jetë subjekt i marrjes së financimeve nga fondi i efikasitetit të energjisë për zbatimin e masave të EE-së.

Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të industrisë kërkon plotësimin e kërkesave me energji në çdo nënsektor industrial (në sasi, cilësi, çmim, siguri dhe kohë). Ky sektor parashikon të luajë një rol të ndjeshëm në rritjen ekonomike, punësimin, rritjen e standardit të jetës etj.

Masat e veçanta të dhëna më poshtë janë rekomandimet kryesore për reduktimin e konsumit të energjisë në sektorin e industrisë:

1. Përmirësimi i menaxhimit;
2. Mirëmbajtje dhe modernizim i teknologjive;
3. Njohje e koncepteve: “teknologji e pastër”, “bashkimi i disa industrive”;
4. Përmirësimet teknologjike, sistemet e kondicionimit të ajrit, ventilimit etj.;
5. Eliminimi sa më shumë të jetë i mundur i qëndrimeve të pajisjeve elektrike në “stand-by”.
6. Rritja e cos  $\varphi$ -së.

Në figurën 8 paraqitet kursimi i energjisë në vlera relative për sektorin e industrisë me qëllim arritjen e objektivit të përcaktuar në paragrafët e sipërpërmendur.




Figura 8. Objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë të efikasitetit të energjisë për sektorin e industrisë në %.

Tabela 11. Masat për PEE-në dhe veprimet që rrjedhin nga zbatimi i këtyre masave në sektorin e industrisë

Kodi	Masat ndihmëse për PEE-në	Elementet e rëndësishme/ hapat e implementimit të masave ndihmëse për PEE-në	Impakti i pritshëm i veprimeve të PEE-së	Kursimet e pritshme të energjisë	Afati kohor për implementimin	Kosto e implementimit nga fondet publike për të gjithë periudhën (euro)	Vlerësimi makroekonomik
	[Instrument politik, p.sh. çfarë masash janë planifikuar për të thjeshtuar veprimet për përmirësimin e eficiencës së energjisë në këtë sektor]	[Përshkrim i detajuar i masave të thjeshtuara për PEE-në, p.sh. duke përmendur “nënmasat”, hapa të ndryshme implementimi etj.]	[Përshkrim sesi masat ndihmëse ndikojnë në planet konkrete]	[Kursimet janë të lidhura direkt me veprimet dhe vetëm indirekt me masat ndihmëse dhe që mund të shprehen me një shifër për disa masa ndihmëse]	[Periudha kohore për implementimin e politikave dhe jo të impaktit]	[Përfshin vetëm koston për buxhetet publike, jo koston totale të veprimeve të PEE-së]	[A është veprimi i PEE-së i planifikuar ekonomikisht i zbatueshëm? A ka efekte ekonomike anësore negative ose pozitive?]
Masat ndihmëse për PEE-në me ndikim ndërsektorial							
Ky seksion përmban masat ndihmëse për PEE-në lidhur me teknologjitë që përdoren në shumicën e sektorëve të industrisë, si motorët, kompresorët e ajrit etj.							
	Skemat e auditimit për industrinë	Futja e skemave audituese për industrinë përfshin hapat e mëposhtëm: -Trajnimin e audituesve të specializuar të eficiencës së energjisë për proceset industriale; -Organizimi i kontrollit të cilësisë për auditivin; -Subvencionim i kontrollit të shpejtë (paraqitja e PEE-së afatshkurtër); -Pagesë e plotë e analizës së hollësishme për veprime më komplekse të PEE-së.	Disponueshmëria e skemave eficiente dhe me cilësi të lartë të auditimit energjetik të projektuara për të identifikuar dhe vlerësuar konsumet energjetike, potencialet e kursimit të energjisë, masat për përmirësimin e EE-së. Industria ofron potenciale të konsiderueshme për kurse energjetike të cilat vijnë nga gjendja teknike e vjetruar e industrisë, nga mungesa e zbatimit të ligjit të EE-së, moskryerja e investimeve për PEE-në, dhe për mungesë të informacionit aq të nevojshëm për të vlerësuar dhe për të matur kursimet energjetike. Skema energjetike ndihmon në zvogëlimin e mungesës së informacionit duke identifikuar dhe veprimet që parashikohen përgjatë procesit të identifikimit, vlerësimit, zbatimit të masave për PEE-në dhe matjen e tyre pas kryerjes së investimeve në të gjitha degët dhe teknologjitë ndërsektoriale të industrisë Shqiptare.	5 Ktoe             22 Ktoe	2011-2018	Fondet publike të parashikuara për të gjitha veprimtaritë: trajnime, kontroll cilësie dhe subvencionimet për kontrollet e shpejta 2 milionë (faza fillestare duke krijuar kontroll cilësie dhe shërbim, kontroll i shpejtë për të gjitha proceset e auditimit)	Implementimi i veprimeve të zbatueshme ekonomikisht për PEE-në përmirëson konkurrencën e industrisë Shqiptare

	<p>Kërkesat minimale të efikasitetit të energjisë për motorët elektrikë, sistemet e ndriçimit dhe furrat industriale</p>	<p>Në kuadër të direktivës 2010/30/EU, del më se e nevojshme transpozimi i kësaj direktive me qëllim që: të plotësohen kërkesat për penetrimin më të madh të pajisjeve eficiente si: motorët elektrikë, termikë, teknologjitë përkatëse, sistemet e ndriçimit etj. Për furrat industriale janë duke u përgatitur kriteret minimale të efikasitetit të energjisë. Përmbajtja e direktivës 2010/30/EU për motorët elektrikë dhe furrat industriale duhet të adoptohet.</p>	<p>Motorët elektrikë, sistemet e ndriçimit dhe furrat industriale përfaqësojnë një përqindje të konsiderueshme të konsumit të energjisë në industrinë e lehtë. Plotësimi i kërkesave minimale të efikasitetit të energjisë do të reduktojë konsumin e energjisë për pajisjet e reja eficiente. - Përmirësimet teknologjike të motorët elektrikë, sistemet e kondicionimit, ventilimit, sistemet e kompresimit të ajrit; - Fikje të pajisjeve elektrike; - Përdorimi i impianteve koogjeneruese më eficientë të lartë</p>	<p>10 Ktoe</p>	<p>Duke filluar nga viti 2011</p>	<p>50,000 (Fondi i EE-së)</p>	<p>Zbatimi i standardeve minimale bazuar në direktivën 2010/30/EU, sjell reduktimin e konsumit/njësi shërbimi</p>
	<p>Promovimi i CHP-ve të vogla për përdorim industrial</p>	<p>Ndërtimi i një qendre të aftë për CHP-të: informacion dhe trajnim, kontroll dhe përmirësim i kushteve ligjore</p>	<p>Për shumë industri, është e nevojshme të kenë në të njëjtën kohë energji elektrike dhe nxehtësi. Veçanërisht për sektorët e industrisë jo intensive (kimike, ushqimore, letrës etj.), CHP-të e vogla lejojnë të përdorin nxehtësinë për të gjeneruar energji termike dhe si rezultat në kursime energjie krahasuar me prodhimin e nxehtësisë dhe energjisë termike veç e veç. Për shkak të kursimeve të kostos së energjisë dhe modeleve të kërkesës konstante në proceset industriale, CHP-të mund të konsiderohen si teknologji ekonomike të zbatueshme në sektorin e industrisë. Pengesa kryesore është mungesa e sensibilizimit dhe informacionit. Prandaj mund të pretendohet që një qendër e aftë informimi me bazë përlogaritjet ekonomike pozitive për CHP-të të ndikojë në rritjen e penetrimit të këtyre skemave në degë të ndryshme të industrisë.</p>		<p>2012-2018</p>	<p>Kosto për krijimin e një qendre kompetente, ngritja e ekspertizës për aktivitete informuese dhe trajnimi; Mund të mbulohen kryesisht nga projekte bashkëpunimi ndërkombëtare. Mundësi financimi nga fondi i EE-së, donatorët, kredi të lehta, bashkëfinancues (50,000)</p>	<p>CHP-të mund të konsiderohen si teknologji ekonomike të zbatueshme për proceset industriale</p>

Masat e PEE-së për sektorë të veçantë intensivë të energjisë							
Ky seksion përmban masat ndihmëse për PEE-në që kanë për qëllim përmirësimet teknologjike të sektorëve të veçantë të cilët përfaqësojnë një përqindje të lartë të konsumit të energjisë në industri.							
	Përfshirje e efikasitetit të energjisë në lejen mjedisore për fabrikat e reja të degëve intensive të energjisë	Në degët intensive të energjisë (industria e çimentos, minierat etj.) përdorimi i teknologjisë më të mirë të mundshme do të përshkruhet në lejen mjedisore për fabrikat e reja ose për implementimin e proceseve të reja.	Nëpërmjet përfshirjes së standardeve të efikasitetit të energjisë në licencimin e fabrikave të reja, përdorimi i energjisë shtesë të panevojshme dhe emetimet e CO <sub>2</sub> mund të kontrollohen që nga fillimi	1% të konsumit total të të gjithë sektorëve  3 Ktoe	Leja mjedisore është e përfshirë. Penetrimi i shpejtë i standardeve energjetike 2011 dhe në vazhdim.	Kosto shtesë të papërfillshme për fondet publike	Fabrikat e reja janë të ndërtuara kryesisht nga kompani ndërkombëtare. Përfshirja e çështjeve energjetike në licencimin e tyre siguron cilësi të lartë dhe standarde mjedisore.
	Marrëveshje vullnetare	Marrëveshje vullnetare për të ndërmarrë disa masa për të përmirësuar teknologjinë e vjetër		2 Ktoe	2012-2018		Sigurisht që sjell kursime energjie gjatë zbatimit të këtyre marrëveshjeve

Tabela 12. Masat e PEE-së në sektorin e industrisë, përshkrim i masave individuale të PE-së

<b>Emri</b>	Auditimet në sektorin e industrisë
<b>Kategoria</b>	Vendosja e skemës audituese për industrinë; Informacion dhe masa detyruese informuese, marrëveshjet vullnetare
<b>Aplikimi</b>	Kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Të gjitha ndërmarrjet industriale objekte të auditimit (përcaktuar në ligjin e EE-së), trajnuesit e licencuar të auditimeve, menaxheret, strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e ligjit të EE-së
<b>Përmirësimi i EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Trajnim i audituesve të efikasitetit të energjisë të specializuar për proceset industriale. Organizimi i kontrollit të cilësisë për auditimin, kontrolli i shpejtë
<b>Efektshmëria</b>	Skemat e auditimit për sektorin e industrisë konsistojnë në: Auditim detyrues për kompanitë e parashikuar në ligjin e EE-së, shërbejnë për identifikimin e situatës teknike dhe ekonomike të degëve të industrisë, vlerësimin e potencialeve për kursimin energjetik, përcaktimin e masave të PEE-së dhe në të njëjtën kohë përbejnë dhe burimin e krijimit, përpunimit të të dhënave me karakter teknik dhe energjetik për degët e industrisë që auditohen, të dhëna të cilat i shërbejnë më së miri përcaktimit në mënyrë të detajuar të konsumeve energjetike sipas burimeve dhe shërbimeve (komoditeteve) dhe kryerjes së analizave, përcaktimit të tendencave të konsumit dhe mbi të gjitha përcaktimi, vlerësimi i intensiteteve energjetike, minimizimi i ndikimeve në mjedis
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik në vitin 2011 dhe 2018</b>	Potenciali i kursimit të këtyre masave vlerësohet 12 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	2011-2018 (2011- fillimi zbatimit të ligjit të efikasitetit të energjisë)

<b>Emri</b>	Respektimi i kërkesave minimale (efiçente) për energji
<b>Kategoria</b>	Respektimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe adoptimi i direktivës 2010/30/EU. Plotësimi i kriterëve të pajisjeve efiçente për motorët elektrikë, sistemet e ndriçimit, furrat e industrisë, boilerët
<b>Aplikimi rajonal</b>	Kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Të gjitha ndërmarrjet industriale, strukturat përgjegjëse për zbatimin e ligjeve, tregtare, prodhues, konsumatorë etj.
<b>Përmirësimi i EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Rritja e efiçencës së energjisë në pajisjet motorike, elektrike, termike, furrat e industrisë, sistemet e ndriçimit. Rritja e efektivitetit tekniko-ekonomik në degët (nëndegët) e industrisë, reduktimi i ndikimit negativ në mjedis
<b>Efektshmëria</b>	Industria ofron potenciale të konsiderueshme për kursimin e energjisë duke sjellë reduktim të konsumit energjetik, përmirësimin e intensitetit të energjisë, respektim të standardeve ndërkombëtare të konsumeve energjetike/njësi prodhimi, ndikim negativ në mjedis më të ulët.
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik në vitin 2011 dhe 2018</b>	Potenciali i kursimit të këtyre masave vlerësohet 20 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	2011-2018

<b>Emri</b>	CHP e vogla për përdorim industrial
<b>Kategoria</b>	Nxitja e përdorimit të CHP-ve të vogla
<b>Aplikimi</b>	Kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Industritë e lehta, prodhues, tregtare, konsumatorë të burimeve energjetike, strukturat përgjegjëse të kontrollit të tregut të pajisjeve efiçente elektrike dhe termike, kreditues, banka etj.
<b>Përmirësimi i EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Ndërtimi i skemave të CHP-ve: Informacion, trajnim, kontroll, përmirësim i kuadrit ligjor (Direktiva e re 2010/30/EU). Kryerja e investimeve për CHP-të, rritja e efektivitetit të fondeve
<b>Efektshmëria</b>	Për shumë nëndegë të industrisë nevojitet në të njëjtën kohë energji termike dhe energji elektrike. Veçanërisht për nëndegët jo intensive (kimike, ushqim, pije, letra etj.) CHP-të e vogla lejojnë përdorimin e nxehtësisë së mbetjeve nga prodhimi i energjisë termike dhe në këtë mënyrë rezultatet në kursimet e konsiderueshme të energjisë krahasohen me vetë nxehtësinë dhe prodhimin e energjisë. Kjo masë sjell rritjen e efektshmërisë së fondeve monetare, redukton konsumin energjetik, më pak ndotës në atmosferë.
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik në vitin 2011 dhe 2018</b>	Potenciali i kursimit të këtyre masave vlerësohet 10 Ktoe.
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	Proces në vazhdim

#### 4.4 Masat për përmirësimin e EE-së në sektorin e transportit

Sektori i transportit konsumon pothuajse 44% të totalit të konsumit final të burimeve të energjisë. Transporti ka njohur rritje të aktivitetit të tij në vitet e fundit. Pjesën dominuese në këtë sektor e zë transporti rrugor me 86% kundrejt totalit, 4% transporti hekurudhor, 4% transporti detar dhe 6% transporti ajror. Tendenca e transportit rrugor pritet të jetë në rritje, duke pasur parasysh për më tepër, politikat për rritjen e kontributit të transportit publik dhe atij hekurudhor në të ardhmen.

Sasia e energjisë së kursyer do të jetë rezultat jo vetëm i masave që parashikohen por dhe i fushatave të sensibilizimit të cilat duhet të ndikojnë në qëndrime të reja kundrejt përdorimit të llojeve të transportit duke parë me përparësi përdorimin e transportit publik, ndryshimin e parkut të automjeteve etj.

Për të arritur objektivat e parashikuara për kursimin e energjisë në sektorin e transportit janë parashikuar këto masa:

- Ndërtimi i rrugëve të reja;
- Rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese, të cilat tashmë janë në proces përmirësimi;
- Përshtatja e kuadrit ligjor në përputhje me direktivat e BE-së për etiketimin e automjeteve sipas klasave A-G në përputhje me nivelin e emetimeve të CO<sub>2</sub>. Kjo duhet të përbëjë detyrim për të gjithë tregtuesit e automjeteve për të bërë prezente etiketimet te konsumatorët;
- Rritja e kontributit të transportit publik;
- Përmirësimi i infrastrukturës së transportit hekurudhor me qëllim rritjen e përdorimit dhe shfrytëzimit të këtij opsioni shumë të leverdishëm;
- Paraqitja e taksave mjedisore për emetimet nga automjetet dhe pagesa e tyre në momentin e regjistrimit dhe të kolaudimit të automjeteve;
- Përdorimi në mënyrë racionale dhe efçente të automjetit nga pikëpamja e dhënies së makinës.

Në figurën 9 janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur kursimet e energjisë nga zbatimi i masave për përmirësimin e EE-së në sektorin e transportit.




Figura 9. Objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë të kursimeve energjetike në sektorin e transportit %



Tabela 13. Masat për PEE-në dhe veprimet që rrjedhin nga zbatimi i këtyre masave në sektorin e transportit

Kodi	Masat ndihmëse për PEE-në	Elementet e rëndësishme/hapat e implementimit të masave ndihmëse për PEE-në	Impakti i pritshëm i veprimeve të PEE-së	Kursimet e pritshme të energjisë	Afati kohor për implementimin	Kosto e implementimit mbuluar nga fondet publike për të gjithë periudhën (Euro)	Vlerësimi makroekonomik
	[Instrument politik, p.sh. çfarë masash janë planifikuar për të thjeshtuar veprimet për përmirësimin e eficiencës së energjisë në këtë sektor]	[Përshkrim i detajuar i masave të thjeshtuara për PEE-në, p.sh. duke përmendur “nënmasat”, hapa të ndryshme implementimi etj.]	[Përshkrim sesi masat ndihmëse ndikojnë në planet konkrete; ndonjëherë disa masa ndihmëse sjellin të njëjtin efekt, p.sh. kontrolli i mjetit mund të rrisë nivelin e informacionit, ndërsa një skemë subvencionimi mund të japë iniciativa shtesë për ndërrimin/përmirësimin ]	[kursimet janë të lidhura direkt me veprimet, dhe vetëm indirekt me masat ndihmëse të cilat mund të shprehen me një shifër për masat ndihmëse ]	[periudha kohore për implementimin e politikave dhe jo të impaktit]	[Përfshin vetëm koston për buxhetet publike, jo koston totale të veprimeve të PEE-së]	[A është veprimi i PEE-së i planifikuar ekonomikisht i zbatueshëm? A ka efekte ekonomike anësore negative ose pozitive?]
Masat e PEE-së në mjete individuale transporti							
Ky seksion përmban masa ndihmëse për PEE-në lidhur me mjetet individuale të transportit, të cilat zakonisht përbejnë një përqindje të lartë të konsumit të energjisë në sektorin e transportit.							
	Etiketimi energjetik i automjeteve të reja	Adaptimi i sistemit të etiketimit energjetik të BE-së për makinat e reja me klasa A-G sipas emetimeve të CO <sub>2</sub> . Detyrimet për makinat e importit/tregtarët e makinave të paraqesin etiketën me të dhënat e konsumit të lëndës djegëse të blerësit.	Etiketimi, informimi mbi standardet energjetike për automjetet do ta bëjë të vetëdijshëm blerësin, qiramarrësin etj. për konsumin e lëndës djegëse/100 km, llojin e lëndës djegëse, emetimet nga automjeti. Si rrjedhim, dokumenti motivon blerësin e makinës që ti japë prioritet konsumit të karburantit kur vendos për blerjen e makinës.	12 Ktoe	2011-2012-2018	Nuk ka nevojë për subvencionim/fonde publike	Meqë investimet shtesë nuk janë të nevojshme, etiketimi është një instrument ekonomikisht i zbatueshëm dhe me shumë ndikim në treg.
	Paraqitja dhe zbatimi i taksave për emetimet CO <sub>2</sub>	Taksat për emetimet e CO <sub>2</sub> nga makinat, të paguhen kur regjistrohet makina. Në procedurën e regjistrimit emetimet e CO <sub>2</sub> janë më se të matshme. Taksatimi për emetimet e CO <sub>2</sub> do të jetë më i lartë për makinat normale sesa për ato eficiente. Shumë makina eficiente (Klasa A, emetimet e CO <sub>2</sub> i kanë nën 100g/100km) do të përjashtohen nga taksat ose do të subvencionohen nga të ardhurat nga	Ky instrument motivon blerësin e makinës që ti japë prioritet blerjes së automjetit që përdor lëndë më pak ndotëse djegëse, mundësisht të pastra (biofuel) etj.	2 Ktoe	2011 dhe në vazhdim	Sistemi i taksave, realizimi i mbledhjes së tyre gjeneron të ardhura për fondet publike ose është kosto neutrale.	Zbatimi i taksatimit sjell të ardhura në fondeve publike, duke i përdorur për qëllime të tjera brenda ose jashtë fushës së eficiencës.

		taksat. Të ardhurat nga taksat mund të përdoren për të financuar masat për eficientë e energjisë në sektorin e transportit ose për të subvencionuar makinat më eficiente.					
Fushata informimi për drejtimin e makinës në mënyrë eficiente (eco-driving)	Elementet e drejtimit të makinës në mënyrë eficiente mund të futen në CV-në e shkollës së mësimit të drejtimit të automjetit; për shoferë me eksperiencë duhet të subvencionohen kurse në makina të vërteta ose imituese; materialet e informimit për stilin e dhënies në mënyrë eficiente dhe kurset që përmenden më lart ti shpërndahen të gjithë pronarëve të automjeteve.	Drejtimi i makinës në mënyrë më të qetë dhe më të sigurtë, aplikimi i parimeve të eco-driving mund të çojë në kursim të karburantit deri në 10%. Megjithatë, për një ndryshim të mënyrës së drejtimit të mjetit materiali informues nuk është i mjaftueshëm, një pasdite kurs eco-driving për shoferët me eksperiencë ka një impakt më të madh	3 Ktoe	2011	100,000	Me edukimin e mësuesve, integrimi në shkollat e drejtimit të automjeteve nuk ka nevojë për suport shtesë; kurset eco-driving për shoferët me eksperiencë mund të bëhen me subvencionime publike	
Masat e PEE-së që ndikojnë në transportin e pasagjerëve .							
Modal split është çështja më e rëndësishme që lidhet me konsumin e energjisë në transportin e pasagjerëve. Ky seksion përmban masa ndihmëse për PEE-në që kanë të bëjnë me ndryshimin e modal-split drejt mënyrave të transportit me eficient kryesisht në zonat urbane. Megjithatë, shumë nga këto masa kërkojnë investime të mëdha në projektet e infrastrukturës. Me gjithë dëshirën politike, këto investime kërkojnë të planifikohen shumë më parë, kështu që nuk është e mundur që ndonjë nga këto masa të jetë efektive brenda periudhës 2012-2018. Gjithsesi, do të listojmë disa shembuj, se ku mund të drejtohen përpjekjet							
Përmirësimi i transportit publik, rritja e numrit të mjeteve të transportit publik (autobusë, trena), përmirësimi i gjendjes së transportit hekurudhor, përmirësimet e cilësisë së shtrimit të rrugëve, shkurtimi i mundshëm i tyre	Struktura e transportit publik do të përmirësohet, në favor të rritjes së linjave të ndara të autobusëve, rritjes së densitetit të linjave të autobusëve, trenave etj.	Rritje e kapacitetit të transportit publik të bashkive do të motivojë njerëzit të kalojnë nga përdorimi i makinave individuale në transportin publik.	(Llogaritja e udhëtarëve për km të kursyer për makinë, shumëzuar me konsumin mesatar të karburantit për person për km; minus rritjen e konsumit për shkak të rritjes të transportit publik.) 10 Ktoe	2012-2018	1,000,000		
Përmirësimi i shërbimit të hekurudhave në qendrat kryesore	Shërbimet e dendura për udhëtimet në qytetet kryesore Tiranë, Durrës, Kavajë etj. (sipas studimit të fazës 2 të planit kombëtar të transportit 2004)	Këto masa duhet të jenë të lidhura me transportin publik të Bashkive. Pa mjete transporti të tjera të përshtatshme, transporti hekurudhor mbetet i pamjaftueshëm	Llogaritja e udhëtarëve për km të kursyer për makinë, shumëzuar me konsumin mesatar të karburantit për person për km; minus rritjen e konsumit për shkak të rritjes së transportit publik. 10 Ktoe	2012-2018			
Promovimi i ecjes në këmbë dhe me biçikleta	Në bashkitë e zgjedhura, ecja në këmbë dhe me biçikleta do të përmirësohet nëpërmjet zonave vetëm për këmbësorë, rrugë vetëm	Siguria e lartë e ecjes në këmbë dhe me biçikleta do të motivojë njerëzit të zëvendësojnë lëvizjen me makina individuale me këto mjete për	Llogaritja e udhëtarëve për km të kursyer për makinë, shumëzuar me konsumin mesatar të	2011 dhe në vazhdim çdo vit		(strukturat përgjegjëse-bashkitë)	

		për biçikleta/korsi biçikletash, parkime të sigurta për biçikleta, zona me shpejtësi të kufizuar për makina etj.	distanca të vogla.	karburantit për person për km 1 Ktoe			
Masat e PEE-së për transportin e mallrave							
Ky seksion përmban masa ndihmëse të PEE-së lidhur me kursimet e energjisë në sektorin e transportit të mallrave							
	Kurset eco-driving për shoferë kamionësh	E ngjashme me sektorin e makinave private, një fushatë eco-driving duhet të bëhet për shoferët e kamionëve.	Kurset eco-driving do të bëjnë që shoferët e kamionëve të drejtojnë mjetet e tyre në mënyrë më eficiente.	3 Ktoe			Kurset do të jenë në shumicën e rasteve të varura nga subvencionimet publike.
	Përmirësimi i shërbimit të transportit hekurudhor të mallrave në rajone me më shumë transport mallrash	Sipas studimit të fazës 2 të planit kombëtar të transportit në Shqipëri, shumica e transportit të mallrave funksionon në një rajon mjaft të vogël rreth portit të Durrësit. Lidhjet hekurudhore për transportin e mallrave që plotësojnë nevojat e kompanive industriale dhe detare do të zhvillohen në mënyrë që të mbulojnë dhe një pjesë të ngarkesës së transportit rrugor.	Shërbimet e reja të transportit do ta bëjnë transportin hekurudhor midis portit të Durrësit dhe qendrave industriale kryesore të vendit me tërheqës.	Llogaritja e ton km zëvendësuar nga hekurudhat, shumëzuar me konsumin mesatar të karburantit për ton km; 11 Ktoe		1,000,000 Me koncesion	

Tabela 14. Masat e PEE-së në sektorin e transportit, përshkrim i masave individuale të PEE-së

<b>Emri</b>	Respektimi i standardeve europiane
<b>Kategoria</b>	Kuadri ligjor dhe rregullator
<b>Niveli i aplikimit</b>	Kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Importuesit e automjeteve, strukturat që kontrollojnë tregun nga pikëpamja e respektimit të standardeve ndërkombëtare, qendrat e regjistrimit dhe kolaudimit të automjeteve, strukturat e taksimit, pronarët e automjeteve etj.
<b>Përmirësimi i EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Reduktimi i konsumit të lëndës djegëse/njësi shërbimi, reduktimi i ndotësve në atmosferë, përmirësim i shëndetit, ndikim i drejtpërdrejtë në rritjen e të ardhurave /njësi shërbimi.
<b>Efektshmëria</b>	Adaptimi i sistemit të etiketimit sipas standardeve të BE-së për automjetet e reja sipas klasave A-G që janë në përputhje me nivelin e ndotjes nga CO <sub>2</sub> . Zhvillimi i standardeve të reja për automjetet apo pajisjet motorike më të lehta, si rezultat edhe blerjen e mjeteve motorike efçente. Reduktimi i konsumit energjetik shoqëruar me një ndikim pozitiv në mjedis. Zvogëlimi i intensitetit energjetik
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik</b>	Potenciali i kursimit energjetik si pasojë e zbatimit të kësaj mase vlerësohet të jetë në vlerën 12 Ktoe.
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	Është në proces zhvillimi: Përmirësimi i cilësisë së rrugëve, taksat doganore të ndjeshme përkundrejt vitit të prodhimit të automjeteve për të nxitur blerjen e automjeteve më efçente dhe me më pak ndotës në atmosferë.

<b>Emri</b>	Mënyra e dhënies së automjeteve
<b>Kategoria</b>	Fushata sensibilizuese apo informuese për dhënien (të ecurit) më efektive të mjeteve motorike
<b>Niveli i aplikimit</b>	Kombëtar
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Mësuesit, trajnerët dhe përdoruesit
<b>Përmirësimi i EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Mënyra e dhënies (ngarjes) së makinës dhe qëndrimi i ri në raport me blerjen e automjeteve më shumë efçente
<b>Efektshmëria</b>	Një fushatë sensibilizuese dhe informuese ka për qëllim nxitjen e mënyrave më të efektshme të dhënies së automjeteve në funksion të kursimit të energjisë. Një masë tjetër tepër e rëndësishme është zbatimi i një kuadri ligjor detyruar për ndryshimin e parkut të automjeteve (efekti i rritjes së taksave doganore për mjetet e vjetra).
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik</b>	Potenciali i kursimit energjetik si pasojë e zbatimit të kësaj mase vlerësohet të jetë në vlerën 7 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	Zbatimi ka filluar në vitin 2010 dhe do të jetë në proces zhvillimi.

<b>Emri</b>	Përmirësimi i transportit publik në nivel bashkie dhe në nivel kombëtar (transporti i pasagjerëve, hekurudhor, detar)
<b>Kategoria</b>	Masa mbështetëse nga pikëpamja financiare, informuese dhe nxitëse për përdorimin e transportit publik me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e efçencës së energjisë
<b>Niveli i aplikimit</b>	Kombëtar dhe lokal për projekte specifike-pilot
<b>Grupet që do të aktivizohen nga aplikimi i masës</b>	Sektori i Transportit, strukturat shtetërore, kompanitë që përdorin mjete motorike, autovetura, shoqëritë e drejtuesve të automjeteve, agjencitë e transportit, sektori privat. Sistemet edukuese të shkollave, mediat
<b>Përmirësimi i EE-së te përdoruesit fundorë</b>	Nxjtja e përdorimit të transportit publik nëpërmjet përmirësimit të tij, rritjes së kapaciteteve, cilësisë së shërbimeve, fluksi, rritja e peshës specifike të transportit hekurudhor. Detyrimi për kryerjen e auditimeve energjetike dhe zbatimi i masave të efçencës në sektorin e transportit
<b>Efektshmëria</b>	Transporti urban dhe hekurudhor, integrimi i tyre gjithmonë e më tepër në një peshë specifike më të madhe përkundrejt transportit publik nëpërmjet përdorimit më në sasi të mjeteve më efçente, të cilat do të rezultojnë me një reduktim të konsumit energjetik dhe me ndikim miqësor në mjedis
<b>Kursimi i pritshëm vjetor energjetik në transport</b>	Potenciali për kursimin energjetik si rrjedhojë e zbatimit të masave të efçencës vlerësohet të jetë në nivelin e 33 Ktoe
<b>Statusi i zbatimit ose periudha kohore për t'u zbatuar</b>	Procesi është në zhvillim (2012-2018)

#### 4.4.1 Vlerësimi i kursimit të energjisë në sektorin e transportit për periudhat 2011-2018 dhe për periudhën e ndërmjetme

Vlerësimi i kursimit të energjisë në sektorin e transportit për periudhën 2010-2018 është paraqitur në tabelën e mësipërme. Kursimi i vlerësuar është bazuar në gjykimin e ekspertit dhe në përvojën ndërkombëtare. Plotësimi i kërkesave të direktivës së ESD-së, do të kërkojë që Shqipëria të krijojë dhe të zhvillojë sistemin për monitorimin dhe verifikimin e energjisë së kursyer jo vetëm për transportin, por për të gjitha sektorët e ekonomisë.

#### 4.5 Masat për përmirësimin e efijencës së energjisë në sektorin e bujqësisë

Shqipëria do të vazhdojë të mbetet një vend me dominim të prodhimit bujqësor. Pesha specifike që zë sektori i bujqësisë vazhdon të mbetet në vlerën me rreth 43% të totalit të GDP-së. Konsumi energjetik në rritjen e prodhimit nga tokat bujqësore, blegtoria dhe pyjet mbetet një alternativë e konsiderueshme për zhvillimin ekonomik dhe social. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë është kushtëzuar nga shumë faktorë të cilët janë:

- Ferma të vogla dhe të fragmentizuara;
- Probleme që ndeshen në pronësinë e tokave;
- Çmime të larta, prodhim dhe shpërndarje jo efektive dhe e paorganizuar e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Mungesa e kreditimeve në bujqësi;
- Mungesa e mekanizimit bujqësor;

Me objektivin për reduktimin e konsumit të burimeve energjetike në vlerën e 5 Ktoe, janë parashikuar këto masa sasiore dhe cilësore:

- Aplikimi i skemave të biomases dhe të prodhimit të biogazit nga impiantet përkatëse në mënyrë efektive;
- Përdorimi i skemave efijente të ujitjes (në formë shiu).

Në figurën 10 janë dhënë në mënyrë të përmblodhur kursimet energjetike në vlerë absolute dhe relative për sektorin e bujqësisë.




Figura 10. Objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë të kursimeve energjetike në sektorin e bujqësisë (%)

#### 4.5.1 Vlerësimi i kursimeve të pritshme të energjisë për periudhën 2011-2012 dhe 2011-2018 në formë horizontale dhe të kryqëzuar.

Nuk është e lehtë për të vlerësuar impaktet e kursimit të energjisë që vijnë si rrjedhojë e zbatimit të masave të EE-së të cilat kanë ndikim të tërthortë apo horizontal.

Masat e EE-së, si etiketimi i pajisjeve energjetike/elektrike të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në kursimin e energjisë, vendosja dhe aplikimi i standardeve të EE-së për produktet në treg, aplikimi i masave të EE-së, sistemi i matjes së konsumit të energjisë, paraqesin vështirësi në

kalkulimin me saktësi të kursimeve të energjisë që rezulton nga secila masë. Këto masa kanë një ndikim në formë paralele apo të tërthortë në përcaktimin e kursimeve të energjisë.

- Masat horizontale

Taksat dhe rregulloret mund të shkaktojnë efekte të ndjeshme të reduktimit të konsumit energjetik në konsumatorët fundorë; sikurse dhe rritja e fushatave të informimit dhe të sensibilizimit sjellin një efekt të ndjeshëm por të vështirë për t'u kalkuluar si një efekt direkt i masës. Të gjitha këto janë parashikuar në PKVEE.

5. Mjetet financiare

Në total, për të gjithë sektorët e analizuar, vlera e fondeve publike të nevojshme për t'u investuar në zbatimin e masave të eficientës parashikohet të jetë në vlerën 6,687,000 Euro.

Sipas sektorëve, financimet parashikohet të jenë:

- Sektori i banesave	1,170,000	Euro
- Shërbimet	1,317,000	Euro
- Industria	2,100,000	Euro
- Transporti	2,100,000	Euro
<b>Totali</b>	<b>6,687,000</b>	<b>Euro</b>

Kërkesa për zbatimin e PKVEE-së ndikon në:

- Reduktim të konsumit energjetik;
- Rritje të sigurisë në furnizim;
- Reduktim të emetimeve në atmosferë;
- Rritje e të ardhurave reale për popullsinë;
- Përmirësim i intensitetit energjetik dhe rritje të komfortit.

#### ANEKS I PËRMBAJTJA E LËNDËVE ENERGJETIKE

Faktorët e konvertimit të burimeve energjetike	kJ	Ktoe	kWh
1 kg qymyr	12 000	2.8656 (E-07)	3.333
1 kg naftë	40 000	9.552 (E-07)	11.111
1 kg gaz natyror	47 200	1.1271 (E-06)	13.10
1 kg dru zjarri	13 800	3.2954 (E-07)	3.833
1 kWh energji elektrike	3 600	8.5968 (E-08)	1

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 4.10.2011  
Doli nga shtypi më 6.10.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë